

		Faqe
	Hyrje	2
KAPITULLI I	Procesi i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Roli i tij	3
KAPITULLI II	Prioritetet Afatmesme 2017-2019	7
KAPITULLI III	Kuadri Fiskal dhe Ekonomik 2017-2019	13
KAPITULLI IV	Parashikimet Buxhetore Afatmesme 2017-2019	18
IV.1	Të Ardhurat e Bashkisë së Tiranës për Periudhën 2017-2019	19
IV.2	Transferrat nga Buxheti i Shtetit	36
IV.3	Parashikimi i shpenzimeve për Periudhën 2017-2019	37
KAPITULLI V	Programet e Zhvillimit të Qytetit .	52

HYRJE

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar) dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor. Përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së PBA-së, kështu buxheti vjetor është viti i parë i PBA-së.

Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë së Tiranës është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, të cilat lidhen me funksionet respektive të pushtetit vendor të përcaktuara në kuadrin ligjor. Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga Njësitë Shpenzuese të përfshira, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse.

Baza mbi të cilën janë përcaktuar sektorët parësorë të zhvillimit dhe identifikimit të prioriteteve të shpërndarjes së burimeve për periudhën 2017-2019 janë kërkesat e qytetarëve, të shprehura përmes diskutimeve publike me qytetarët e të 24 njësive administrative dhe programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë për vitet 2015-2019.

Ky projekt-buxhet bazohet në vizionin tonë për Tiranën e së ardhmes, e cila para së gjithash duhet të jetë një qytet i jetueshëm, me infrastrukturë moderne e transport publik cilësor, me shërbime efikase e cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jetë kulturore të larmishme e me hapësira të dedikuara për fëmijët, të moshuarit, këmbësorët e çiklistët. Ne besojmë se pavarësisht problemeve të shumta, Tirana fsheh një potencial të jashtëzakonshëm ekonomik, social e kulturor. Mundësitë e arritjes së këtij potenciali për zhvillim bëhen edhe më të mëdha me ndarjen e re territoriale, e cila duke e zgjeruar Tiranën me 13 njësi të reja, do t'i japë qytetit hapësirë për të marrë frymë e për t'u zhvilluar edhe më tej.

Buxheti afatmesëm 2017-2019 parashikon investime në projekte të mëdha si Zgjatimi i Bulevardit të Tiranës, Unaza e Madhe, Pazari i Ri, Parku Zoologjik, Infrastruktura Arsimore dhe Terminali i Autobuzëve.

Një nga risitë më të mëdha që do të sjellë viti i ardhshëm do të jetë edhe Plani i Përgjithshëm Vendor – Tirana 2030, i cili do të përcaktojë se si do të duket Tirana e së ardhmes. Në ndryshim nga planet vendore të mëparshme, ky plan nuk do të bazohet vetëm mbi proceset e zhvillimit të qëndrueshëm urban, por do të trajtojë edhe çështjet e transportit dhe lëvizshmërisë, zhvillimin ekonomik, infrastrukturës, menaxhimin e aseteve natyrore dhe riintegrimin social.

KAPITULLI I PROCESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE ROLI I TIJ

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë e Tiranës, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritarë të identifikuar në Programin e Bashkisë së Tiranës dhe në dokumentat e tjerë strategjikë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Rol domethënës në hartimin e kësaj PBA-je kanë luajtur edhe qytetarët e Tiranës, të cilët në kuadër të takimeve “Buxheti me pjesëmarrje” kanë shprehur prioritetet e tyre për shpenzimet publike.

Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- a. Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.
- b. Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:
 - Një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
 - Forcimi i lidhjes mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- Krijimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve politike, të shprehura në programin politik të Bashkisë së Tiranës, dhe prioritetëve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion;
- Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare);
- Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritetë të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve;
- Inkurajimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve;
- Forcimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.

Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm:

Programi Buxhetor Afatmesëm është instrumenti më i rëndësishëm i menaxhimit financiar, i cili synon integrimin e programit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për mandatin 2015-2019 me nevojat e qytetarëve duke i përkthyer në politika vendore dhe konkretizuar në plane shpenzimesh.

Ky dokument synon të informojë Këshillin Bashkiak të Tiranës dhe publikun e gjerë lidhur me planet afatmesme të shpenzimeve të Bashkisë, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave strategjike të programit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Dokumenti synon t'i japë mundësinë Këshillit Bashkiak, si organ vendimmarrës, për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh në periudhë afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të Bashkisë.

Ky program iu shërben gjithashtu Njësive Shpenzuese pasi mundëson përcaktimin në mënyrë të qartë prej tyre të politikave dhe programeve për çdo aktivitet, për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Ky proces synon parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale, si një mjet që përkthen qëllimet dhe objektivat strategjike në synime financiare, duke prezantuar politikat fiskale dhe financiare të Bashkisë së Tiranës.

Gjithashtu, parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve dhe përcaktimi i fondeve afatmesme në dispozicion për investime, krijojnë mundësinë për vlerësimin e aftësive kredimarrëse të Bashkisë së Tiranës, dhe lejon në këtë mënyrë përdorimin e një instrumenti alternativ për rritjen e investimeve kapitale, të financuar nga burime të jashtme dhe të brendshme, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve në dobi të komunitetit.

Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm:

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program. PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërthurur me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese.

Shpenzimet:

- a. Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, interesa),
- b. Shpenzimet kapitale.

Njësitë Shpenzuese:

- a. Aparati i Administratës së Bashkisë së Tiranës
- b. Institucionet e varësisë

Konsultimi i Programit Buxhetor Afatmesëm:

Bashkia e Tiranës i jep përparësi thelbësore përfshirjes qytetare si hallkë e rëndësishme në vendimmarrje, për sa i përket projekteve, investimeve dhe shërbimeve që ky institucion garanton ndaj qytetarëve të kryeqytetit. Vendimmarrjen me pjesëmarrje Bashkia e zbaton edhe në bazë të parimeve themelore të funksionimit të një qeverisje demokratike dhe të shtetit të së drejtës, parime të tilla si: parimi i transparencës, gjithëpërfshirës, zbatimit të ligjshmërisë, subsidiaritetit etj.

Në mbylljen e vitit kalendarik 2016, i cili shënoi arritje historike për këtë Bashki, me heqjen e saj nga lista e zezë e borxheve të trashëguara – falë mbledhjes së mirë të taksave dhe tarifave vendore – investime publike dhe punime intensive në çdo cep të Tiranës.

Dëgjesat dhe konsultimet publike mbi projektbuxhetin me pjesëmarrje u realizua edhe këtë vit në 11 njësitë më të mëdha administrative, ku u paraqitën projektet e nisura tanimë (Pazari i Ri dhe sheshi “Avni Rustemi”, sheshi “Skënderbe”, zgjatimi i bulevardit etj.), të cilat do të vijojnë edhe gjatë vitit 2017, si edhe ato risi në punë dhe investime publike, të cilat parashikohen të financohen dhe realizohen gjatë viteve të ardhshëm.

Gjatë këtyre dëgjesave të zhvilluara në muajin nëntor 2016, u zhvillua gjithashtu një sondazh mbi projektbuxhetin e vitit 2017. Qëllimi i këtij sondazhi ishte të evidentonte mendimin qytetar rreth nevojave dhe prioriteteve që ka secila zonë në veçanti dhe vlerësimin e qytetarëve pjesëmarrës në dëgjesat publike për cilësinë dhe informacionin e prezantimit të projektbuxhetit të secilën njësi administrative.

Nga ky sondazh rezulton se **79%** e të intervistuarëve janë grup-moshat **nga 30 në 65 vjeç**, nga të cilët **51% meshkuj** dhe **49% femra**. Për sa i përket informacionit të ofruar në dëgjesat publike **34%** e qytetarëve e kanë cilësuar **të mjaftueshëm**, **61% të plotë** dhe vetëm **5% si të pamjaftueshëm**.

Nevojat dhe sugjerimet e ardhura nga qytetarët variojnë në funksion të zonave të banimit dhe problematikave të ndryshme që këto paraqesin, sipas shembujve të mëposhtëm:

- Në Njësinë Administrative **Nr.2** nevojat më të shumta shkojnë për **infrastrukturë rrugore** dhe përmirësim të shërbimit të **transportit publik**.
- Në Njësinë Administrative **Nr.3** kërkesat më të shumta janë për **kanalizime** ndërsa Njësia Administrative **Nr.5** konsideron si më prioritare **rigjenerimin e objekteve të vjetra**.
- Në Njësinë Administrative **Nr.6** kërkesat më të shumta janë për **çerdhe** ndërsa në Njësinë Administrative **Nr.7** për **punësim dhe kujdes social**.

- Banorët e Njesisë Administrative **Nr.8** konsiderojnë prioritare ndërtimin e **terreneve sportive**, ata të Njesisë Administrative **Nr.10 ndërtimin e parkimeve** ndërsa Njësia **Nr.11 më shumë tregje dhe qendër kulturore**.

Nga përmbledhja e rezultateve për të përftuar të dhëna për 11 njësitë administrative së bashku, rezulton se **55%** e të intervistuarve konsiderojnë **prioritare** investimet në **infrastrukturë rrugore** dhe elementët plotësues të saj, **50%** kërkojnë më shumë **punësim** dhe rreth **45%** më shumë **gjelbërim** dhe **pastrim** në kryeqytet.

Gjithashtu interes i theksuar është treguar për zhvillimin e dëgjësive publike, prezantime të cilat vlerësohen nga qytetarët si shumë të rëndësishme dhe eficente.

Prioritetet afatmesme të reflektuara në PBA 2017-2019 mbështeten në kërkesat e qytetarëve të Tiranës dhe në Programin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për mandatin 2015-2019.

➤ **Prioritetet e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Objektiviti themelor i PBA-së do të jetë kthimi i Tiranës në një qytet të jetueshëm. Ky objektiv do të realizohet përmes mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes, garantimit të cilësisë në tregjet publike dhe rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollore; përmirësimit të kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimit të shërbimeve sociale cilësore; meremetimit të infrastrukturës rrugore, përmirësimit të transportit publik, lehtësimit të trafikut dhe zgjidhjes së problemit të parkimit; fuqizimit të rinisë dhe shtresave të tjera, rigjallërimit të jetës kulturore dhe masivizimit të sporteve; nxitjes së të bërit biznes, rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale dhe turizmit.

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit afatmesëm do të jenë pikërisht këto synime:

- **Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit e sipërmarrjes;**
- **Ofrimi i shërbimeve cilësore;**
- **Eliminimi i mësimi me dy turne dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore;**
- **Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit;**
- **Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes;**
- **Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;**
- **Ndërtimi i veprave të mëdha publike.**

➤ **Projekte Strategjike:**

Në PBA-në 2016-2018 ishin përfshirë një sërë projektesh strategjike, të cilat ose janë shumë pranë përfundimit ose janë realizuar tashmë.

Projekti i Rigjenerimit Urban të Pazarit të Ri dhe Sheshit Avni Rustemi është drejt përfundimit dhe pritet të inagurohet në mars të vitit 2017. Aktualisht ka përfunduar ndërtimi i tregut të fruta-perimeve dhe rikualifikimi i Sheshit Avni Rustemi dhe i gjithë zonës deri tek Markata. Ndërkohë janë duke u përmbyllur punimet për ndërtimin e strukturës së re ikonike përfaqësuese të Pazarit të Ri si edhe rikonstruksioni tërësor i markatës së mishit dhe peshkut. Faza e fundit e punimeve lidhet me ndërhyrjet në të gjitha fasadat që shohin drejt Pazarit të Ri me qëllim unifikimin e tyre.

Projekti i Bulevardit të ri dhe Rehabilitimit të Lumit të Tiranës është duke përfunduar me ritme të shpejta. Momentalisht është drejt përfundimit parkimi nëntokësor, që në fillim të vitit 2017 do t'i shtojë qytetit 305 vendparkime të reja, të cilat do të menaxhohen nga Bashkia Tiranë. Kanë përfunduar galeritë e shërbimit dhe muret kufizues deri tek Km. +1.200; po punohet me

nënshtresat përfundimtare nga Km. +0.000 - +0.500, duke hapur rrugë më pas për mobilimin urban dhe përfundimin e plotë të këtij segmenti. Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Fondin e Abu Dhabit, ka rishikuar projektin e Bulevardit, duke prezantuar në projektin e ri edhe Parkun e Qendror të Tiranës, i cili nuk ishte i parashikuar në projektin e vjetër. Në lumin e Tiranës, është realizuar në masën 80% volumi i punimeve dhe në masën 90% rrjeti i kanalizimeve. Kanë mbaruar plotësisht 17 pritrat shuarse të Lumit, kanë përfunduar argjinaturat mbrojtëse kryesore dhe dytësore në pothuajse të gjithë gjatësinë e Lumit dhe është duke u punuar me mbjelljen e barit, ne brigjet e mbrojtjeve dytësore dhe në hapësirat e krijuara ndërmjet këtyre mbrojtjeve.

Projekti i Ndërtimit të Unazës së Vogël ka përfunduar plotësisht. Ka përfunduar segmenti i parë që fillon nga ushtari i Panjohur deri tek kryqëzimi i Rr. së Barrikadave me Rr. e Dibrës; ka përfunduar segmenti i dytë që nis nga Rr. e Barrikadave deri tek Bulevardi Zog I, segmenti i tretë që fillon tek kryqëzimi me bulevardin Zogu i parë dhe gjithashtu edhe segmenti i katërt, tek kryqëzimi me rrugën e Kavajës.

Projekti i Rikonstruksionit të Sheshit Skënderbej ka ecur me ritme shumë të shpejta dhe pritet të përfundojë brenda gjysmës së parë të vitit 2017. Aktualisht është përgatitur kantieri i ndërtimit, janë spostuar me një ndërhyrje kirurgjikale e me makineri të veçantë të gjitha pemët ekzistuese. Si rezultat i drejtëpërdrejt i degjesave publike të mbajtura për projektin jemi duke punuar me ritme të shpejta edhe për krijimin e një parkimi nentokesor publik. Aktualisht ka përfunduar pjesa e germimeve dhe deri në pranverë do të përfundojë pjesa strukturore për mospengimin e sipërfaqes së sheshit. Sheshi do t'u dhurojë qytetarëve të Tiranës 11 lulishte të reja si dhe hapësirën pedonale më të madhe në Ballkan e cila do të shërbejë si një qendër fokale sa i përket aktiviteteve artistike dhe kulturore të qytetit.

Projekti për Rehabilitimin e Parkut të Madh të Tiranës ia ka arritur të përmirësojë infrastrukturën ekzistuese duke rehabilituar shtigjet dhe rrugicat dhe, gjithashtu, duke i pajisur ato me ndriçim. Gjithashtu, në këtë park u ndërtua edhe këndi më i madh i lojërave në Tiranë, i cili është atraksioni kryesor për fëmijët e kryeqytetit. Gjatë vitit 2017 në Parkun e Madh do të ndërhyhet edhe për shtimin e një piste vrapimi dhe një piste biçikletash.

Me mbështetjen e donatorëve dhe partnerëve të rëndësishëm, Bashkia e Tiranës do të realizojë një sërë veprash të mëdha të infrastrukturës së qytetit përmes PBA 2017-2019. Disa nga këto projekte janë:

1. Shkollat e reja

Në Bashkinë Tiranë gjenden gjithsej 191 shkolla publike. 61 shkolla kanë më shumë nxënës se sa kapaciteti i tyre maksimal dhe 57 shkolla e zhvillojnë mësimin me dy turne. Për t'u dhënë një zgjidhje përfundimtare këtyre tre problemeve, duhet të ndërtohen 17 shkolla të reja, nga të cilat 10 shkolla të ciklit 9-vjeçar, të cilat do të përfshijnë edhe ambiente për kopshte brenda tyre, dhe 7 shkolla të ciklit të mesëm të lartë. Në NJA2 do të ndërtohen 3 shkolla të reja, dy 9vjeçare dhe një e mesme. Në NJA5 do të ndërtohet një shkollë 9 vjeçare. Në NJA7 do të ndërtohet një shkollë e mesme. Në NJA8 do ndërtohet një shkollë 9vjeçare dhe një shkollë e mesme. Në NJA9 do ndërtohet një shkollë 9vjeçare dhe një e mesme. Në NJA11 do ndërtohen dy shkolla 9vjeçare dhe një shkollë e mesme. Në NJA Dajt do ndërtohet një shkollë e mesme. Në NJA Farkë do

ndërtohet një shkollë 9 vjeçare. Në NJA Kashar do ndërtohetn dy shkolla 9 vjeçare dhe një shkollë e mesme. Të gjitha shkollat 9vjeçare do të kenë edhe kopësht të integruar.

2. Zgjerimi dhe sistemimi i shtratit të Lanës

Për vitin 2017 Bashkia e Tiranës do të parashikojë realizimin e dy segmenteve për zgjerimin dhe sistemimin e shtratit të Lanës në të dy krahët e tij. Segmenti i parë që do të ndërtohet do të jetë ai nga Pallati me Shigjeta deri tek ura e Unazës së Madhe, që kufizohet me Kasharin. Pjesa e dytë do të jetë nga materniteti i ri deri në urën e Shkozës, projekt i miratuar dhe i financuar nga qeveria. Bashkia e Tiranës është duke përfunduar planin e shpronësimeve dhe pastrimit të territorit nga objektet për t'i dhënë rrugë implementimit. Më përfundimin e këtij projekti, jo vetëm që do të sistemohet shtrati i lumit, por do të shtohen edhe hapësira publike për banorët e këtyre lagjeve.

3. Pylli orbital

Pylli Orbital është një projekt i rëndësishëm për krijimin e një mushkërie urbane për qytetin e Tiranës. Pylli orbital do të shërbejë si një rrip që kufizon zhvillimin e dëndur urban dhe ndan Tiranën urbane me Tiranën periurbane dhe rurale. Plani i Përgjithshëm Vendor planifikon mbjelljen e 2 milion pemëve në këtë brez të ri të gjelbër të qytetit me qëllim që brezat e ardhshëm të qytetareve të Tiranës të kenë akses në një park linear që rrethon qytetin si dhe rritja e dëndësisë së gjelbërimit urban pritet të ketë një efekt të drejtëpërdrejt në cilësinë e ajrit. Kjo ndërhyrje, së bashku me sheshin qendror pedonal, rrjetin minimal të biçikletave dhe qendrat e reja urbane të Tiranës pritet të kenë një impakt të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit të banoreve të qytetit tonë.

Bashkia e Tiranës do të parashikojë që në buxhetin e vitit të ardhshëm investimin në bimësi prej 1 milion USD.

4. Terminalet e Transportit

Administrata e re e Bashkisë Tiranë rizgjoi një projekt i cili flinte për vite me rradhë në sirtarë, edhe pse ishte kryer një studim fizibiliteti dhe ekzistonte mundësia reale e financimit. Në bashkëpunim me EBRD dhe konsulentin e tyre ndërkombëtar, ItalFerr, Bashkia rishikoi studimin e fizibilitetit të Terminalit, duke hequr disa komponentë të parëndësishëm e tepër të kushtueshëm të projektit origjinal, duke minimizuar kështu riskun për Bashkinë dhe taksapaguesit, dhe në të njëjtën kohë duke rritur shkallën e efektivitetit dhe të financueshmërisë së Projektit. Brenda dy muajve të parë të vitit Bashkia do të negociojë kontratën e koncesionit, e cila do të garantojë ndërtimin e Terminalit, operacionalitetin e tij sipas standarteve ndërkombëtare, si dhe prurjen e të ardhurave financiare për Bashkinë. Aspirata e Bashkisë është që ky Terminal të ndërtohet brenda vitit 2017. Në projektet e Bashkisë së Tiranës është edhe Terminali jug-lindor i Tiranës i cili parashikohet të përballojë fluksin e autobusëve dhe furgonëve që hyjnë në Tiranë nga rr. e Elbasanit, përkatësisht autobusët që vijnë nga Korça, Pogradeci, Librazhdi, Përrenjasi dhe Elbasani si edhe autobuset që vijnë nga Maqedonia.

5. Tirana-Një qytet policentrik

Plani i ri i Pergjithshem Vendor i Tiranës parasheh një qytet me 5 qendra të reja urbane në Kombinat, Kinostudio, Laprakë, tek Bulevardi i ri si dhe në Shkozë. Në këto qendra do të merren masa për nxitjen e investimeve private si dhe investime publike të Bashkisë në infrastrukturë sekondare dhe shkolla të reja si qendra komunitare me qëllim përqëndrimin e një mase kritike kapitali në një hapësirë qendore urbane. Kjo qasje do të rrisë cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të ofruara në këto zona të ndërlidhura mirë me njëra tjetrën me transport publik si dhe me rrjetin minimal të bicikletave. Bashkërendimi i këtyre do të rrisë aksesin e qytetarëve në shërbime pranë vendbanimeve të tyre si dhe do të krijojë disa qendra të reja me karakteristika të ndryshme nga njera tjetra: qendra universitare, artizanale, artistike, mediatike etj.

6. Rrjeti minimal i biçikletave

Rrjeti Minimal i Bicikletave do të krijojë një skelet me korsi të dedikuara dhe të veçuara nga trafiku për qytetarët që përdorin biçikletën si mjetin kryesor të lëvizjes së përditshme. Në fazën e parë, qëllimi i këtij projekti është krijimi me shpejtesi i korsive të dedikuara në akset kryesore radiale dhe transversale të qytetit: Rrugën e Dibrës, Rrugën e Durrësit, Rrugën e Kavajës, Bulevardin Zogu i Parë dhe Bulevardin Dëshmoret e Kombit, Unazën e parë dhe të tretë të qytetit. Korsitë e dedikuara të biçikletave do të rrisin në formë eksponenciale sigurinë në rrugë të drejtuesve të biçikletave si dhe do të rrisin nëpërmjet një investimi të vogël në infrastrukturë numrin e njerëzve që përdorin këtë mjet në përditshmëri. Kjo rritje do të sillte një ulje të përdoruesve të automjeteve duke patur një impakt të drejtpërdrejtë në lëvizshmërinë e trafikut si dhe në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e qytetarëve të Tiranës.

➤ Ndërhyrjet në infrastrukturën e qytetit:

1. Rrugët dhe Transporti Publik

Investimet brenda këtij programi do të përmirësojnë edhe më shumë cilësinë e infrastrukturës rrugore, duke aplikuar standartet më të larta në gjithë territorin e Bashkisë Tiranë dhe do të përbëjnë 39% të buxhetit të investimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017 – 2019, me një rritje prej 15% në krahasim me planifikimin e vitit 2016.

Gjatë vitit 2017 do të riparohen 48,000 m² të infrastrukturës ekzistuese, me një mesatare prej 2,000 m² për çdo njësi administrative. Përveç investimeve në rrugica e blloqe banimi, do të riparohen rreth 24,000 m² trotuare, me një mesatare prej 1,000 m² për çdo njësi administrative.

Duke i dhënë përparësi sigurisë në rrugë, gjatë vitit 2017 do të synohet rikualifikimi tërësor i gjithë infrastrukturës horizontale dhe vertikale. Gjithashtu, do të pajisen me sinjalistikën e nevojshme korsitë e autobusëve urbanë në unazën e mesme dhe unazën e vogël, si edhe në disa prej rrugëve që lidhen me to. Përgjatë këtyre dy unazave dhe në rrugët që lidhin ato do të krijohen korsitë e biçikletave e do të pajisen me sinjalistikën përkatëse.

Në kuadër të reformës administrative dhe zgjerimit të territorit të Bashkisë Tiranë, vitin e ardhshëm do të rikonceptohen dhe ristrukturohen linjat e transportit urban në përputhje me ndarjen e re territoriale. Modernizimi i transportit publik është, gjithashtu, një prioritet i rëndësishëm dhe në vitin 2017 do të hartohet, testohet dhe zbatohet biletimi elektronik. Për të reduktuar trafikun do të kryhet transferimi i linjave të transportit ndërqytetas dhe ndërkombëtar jashtë unazës së mesme, deri në ndërtimin e terminaleve të udhëtarëve.

2. Shërbimet Publike Vendore

Ky program synon ta shndërrojë Tiranën në një qytet sa më të jetueshëm. Investimet brenda këtij programi, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës në blloqet e banimit do të përbëjnë 26% të buxhetit të investimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019, me një rritje prej 29% në krahasim me planifikimin e vitit 2016.

Një nga objektivat më të rëndësishëm do të jetë garantimi i pastërtisë në rrugë dhe në hapësirat publike. Gjatë vitit të ardhshëm do të rikonceptohen dhe strukturohen zonat dhe shërbimet e pastrimit në gjithë territorin e Tiranës, në kuadër të reformës administrative. Gjithashtu, në zonën brenda unazës së mesme do të pilotohet ndarja dhe diferencimi i mbetjeve urbane, duke i dhënë përparësi kështu riciklimit.

Ndriçimi do të jetë një nga përparësitë kryesore gjatë vitit të ardhshëm dhe do të synohet rikualifikimi i rrjetit ekzistues në masën 100% duke riparuar ndriçuesit e dëmtuar dhe duke zëvendësuar ata që mungojnë.

Ndërkohë, përsa i përket parkimeve, përveç kontrollit dhe normalizimit të vend-parkimeve në rrugë, është programuar hapja e 10 shesheve të reja të parkimit publik.

Gjatë vitit 2017, përparësi do t'i jepet gjelbërimit dhe hapësirave çlodhëse. Kësisoj, është planifikuar mbjellja e pemëve dhe bimësisë dekorative, si edhe pajisja me kosha mbeturinash dhe stola, në 33 rrugë, 13 blloq banimi dhe 15 lulishte.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe krijimit të këndeve sportive të reja apo rehabilitimit të atyre ekzistuese. Gjithashtu, përsa i përket sportit, do të zbatohet edhe një projekt për të krijuar klasat sportive në çdo shkollë të Tiranës.

3. Arsimi Parauniversitar

Investimet brenda këtij programi, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës arsimore si dhe ambjenteve ndihmëse e rekreative në të gjitha objektet arsimore, do të përbëjnë 19 % të buxhetit të investimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019, me një rritje prej 17% në krahasim me planifikimin e vitit 2016.

Duke qenë se Bashkia e Tiranës ka parashikuar ngritjen e një skeme të partneritetit publik privat për ndërtimin e 17 shkollave të reja, në këtë program nuk janë parashikuar investime për ndërtimin e shkollave të reja. Me ndërtimin e 10 shkollave të reja 9-vjeçare dhe 7 shkollave të reja të mesme, në qytetin e Tiranës do të marrë fund njëherë e përgjithmonë problemi i mësimi me dy turne. Përmes partneritetit publik privat, shkollat e reja do të ndërtohen me financimin e koncensionarit dhe Bashkia Tiranë do t'i paguajë me këste vjetore për një periudhë 7 vjeçare me anë të të ardhurave të mbledhura nga Taska e përkohshme për infrastrukturën arsimore.

Si rezultat i përmbushjes së nevojës për shkolla të reja, investimet brenda këtij programi do të përqëndrohen kryesisht në rindërtimin e shkollave ekzistuese dhe ndërtimin/rindërtimin e kopshteve dhe çerdheve.

Vëmendje maksimale do t'i kushtohet ngrohjes në objektet arsimore. Kësisoj, është parashikuar rehabilitimi i infrastrukturës dhe vendosja në efikasitet të plotë i ngrohjes në 208 shkolla 9-vjeçare e të mesme dhe 69 kopshte në të 24 njësitë bashkiake që përbëjnë Tiranën.

4. Kujdesi Social

Kujdesi Social është gjithashtu një prioritet, duke synuar përmirësimin e infrastrukturës së të gjitha çerdheve të qytetit. Falë nismës “Adopto një çerdhe”, pjesa më e madhe e çerdheve të Tiranës janë rindërtuar ose rehabilituar. Kjo nuk nënkupton aspak se detyrimi për të përmirësuar kushtet për vogëlushët është përmbushur.

Në këtë program është parashikuar ndërtimi i disa çerdheve të reja, në varësi të nevojave që kanë njësitë administrative. Gjithashtu, do të garantohet mirëmbajtja dhe ngrohja gjatë dimrit për 36 çerdhe.

Gjatë vitit 2017 do të synohet që të rritet kapaciteti i kopshteve dhe çerdheve me të paktën 10% si edhe të përmirësohen mjediset duke vendosur kënde lojrash në oborret e tyre. Përparësi do t'i jepet edhe trajnimit të stafit në mënyrë që fëmijët të përfitojnë një shërbim sa më të përshtatshëm.

5. Strehimi

Për të përmirësuar dhe rritur cilësinë e kushteve të jetesës për familjet në nevojë për strehim të cilët nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofërtën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore, Bashkia e Tiranës synon të rifillojë programin e banesave me kosto të ulët, zbatuar nga viti 2009-2013 përmes një marrëveshjeje të nënshkruar nga disa aktorë si (Ministria e Financës, Banka Kombëtare Tregtare, Bashkia e Tiranës etj) bazuar në fonde buxhetore të alokuara në nivel qendror nga Ministria përgjegjëse për zhvillimin Urban.

Duke qenë se aplikimet për këtë program kanë vazhduar, Bashkia e Tiranës do të marrë përsipër të vazhdojë këtë program duke u bazuar në burimet e veta financiare. Në buxhetin e vitit 2017 është parashikuar fondi prej 95 milionë lekë me të cilin do të subvencionohen interesat për rreth 1000 kredi të buta që bashkia do të mbështesë gjatë këtij viti.

Politikat tatimore dhe parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë e Tiranës është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to.

Si rrjedhim i ndryshimeve ligjore për taksat vendore , të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2017, paraqiten me një rritje prej 13% në krahasim me vitin 2016, ndërsa për vitet 2017 e 2018 mendohet të kenë rritje përkatësisht me 1% dhe 2% më shumë se viti respektiv i mëparshëm.

Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për këtë periudhë afatmesme reflekton dhe ndryshimet në paketën fiskale si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

- ✓ Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- ✓ Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- ✓ Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse &tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve;

Struktura e të Ardhurave 2017-2019

Të ardhurat	<i>Në lekë</i>		
	2017	2018	2019
Tatimore	7,074,590,000	7,249,500,000	7,437,060,000
Jo tatimore	4,789,210,000	4,655,500,000	4,699,000,000
Transferta e pakushtëzuar	1,913,119,744	1,951,382,139	1,990,409,781
Totali	13,776,919,744	13,856,382,139	14,126,469,781

Zhvillimet e fundit fiskale

Ndryshimet ligjore të fund-vitit 2015 në sistemin fiskal, nga njëra anë, lehtësuan biznesin dhe, nga ana tjetër, ndihmuan në rregullimin dhe normalizimin e situatës në shumë sektorë të ekonomisë lokale. Këto ndryshime, njëkohësisht, rritën të ardhurat e Bashkisë Tiranë, duke bërë të mundur ofrimin e më shumë shërbimeve me një cilësi më të lartë.

Gjatë vitit 2016, paketës fiskale i janë bërë disa ndryshime të cilat kanë pasur synimin e vetëm që të lehtësojnë edhe më shumë barrën për biznesin. Kështu, përmes VKB nr. 8, datë 11.03.2016, “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2016 ‘Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës’”, pas konsultimeve të shumta me biznesin, u ndryshua zonimi sa i përket tarifës për zënien e hapësirës publike. Zona A, e cila ka edhe nivelin më të lartë të kësaj tarife, u ngushtua duke u përqëndruar në rrugët kryesore dhe në qendër. Si rrjedhim, shumë biznese që më parë ishin në zonën A u përfshinë në zonën B, çka solli një përgjysmim të tarifës së zënies së hapësirës publike për ta. Po në kuadër të dialogut me biznesin, pas kërkesave të tyre, u përjashtuan nga detyrimi për të paguar taksën e përkohëshme mbi infrastrukturën arsimore të gjitha NIPT-et sekondare.

Gjithashtu, përmes VKB nr. 34, datë 23.05.2016, Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2016 ‘Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës’” u përjashtuan të gjitha bizneset e reja nga detyrimi për të paguar taksat dhe tarifat vendore për një periudhë 3 mujore nga krijimi i tyre. Kjo masë i ndihmon të gjitha bizneset e reja që të rriten më shpejt pasi u jep mundësinë që të konsolidohen njëherë në treg e pastaj të paguajnë taksa.

Një masë shumë e rëndësishme për lehtësimin e bizneseve ka të bëjë me thjeshtimin e procedurave të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore për të gjitha biznset që operojnë në Tiranë. Për 6 procedurat kryesore të DPTTV u përgjysmuan dokumentet që u kërkoeshin bizneseve dhe u përgjysmuan, gjithashtu, edhe afati kohor i realizimit të këtyre procedurave.

Për vitin 2017, paketa fiskale nuk do të pësojë asnjë ndryshim, duke mbetur e njëjtë si në vitin 2016. Më poshtë një përshkrim më i detajuar:

1. **Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël** do të mbetet në të njëjtin nivel si më parë. Kështu, biznesi me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë do të paguajë **zero** taksa. Ndërsa biznesi me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë lek do të paguajë 5% të fitimit të tatueshëm.
2. **Taksa mbi pasuritë e paluajtshme** për shtëpitë e banimit, mbetet në të njëjtin nivel si më parë. Gjithashtu, do të aplikohet ulja me 30% për njësitë administrative Bërzhitë, Baldushk Vaqarr, Pezë, Petrelë, Krrabë, Ndroq, Shëngjergj, Zall Herr dhe Zall Bastar. Përsa u përket ndërtesave për tregti, kjo taksë nuk ndryshon po ashtu. Në 10 komunat e sipërpërmendura kjo taksë është sërish 30% më e ulët se në pjesën tjetër të Tiranës.

3. **Taksa mbi truallin** do të jetë në të njëjtin nivel, ku individët do të paguajnë vetëm 0.56 lek/m² në vit ndërsa bizneset vetëm 20 lekë/m² në vit.
4. **Taksa e fjetjes në hotel** do të jetë 350 lekë/nata për hotelet me 4-5 yje, ndërsa për bujtinat, motelet etj do të jetë vetëm 140 lekë për çdo natë.
5. **Taksa e ndikimit në infrastrukturë** do të vazhdojë të llogaritet në kufijtë 4% deri në 8% të çmimit të shitjes.
6. **Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme** do të vazhdojë të jetë 1100 Lek/m² për ndërtesat e banimit, 2200 Lek/m² për ndërtesat për tregti dhe shërbime dhe 1550 Lek/m² për ndërtesat e tjera. Ndërkohë, do të vazhdojë të aplikohet ulja me 30% për njësitë administrative Bërzhitë, Baldushk Vaqarr, Pezë, Petrelë, Krrabë, Ndroq, Shëngjergj, Zall Herr dhe Zall Bastar.
7. **Taksa e tabelës** për tabelat identifikuese deri në 2 m² do të mbetet zero. Për tabelat mbi 2 m², pra për tabelat reklamuese kjo taksë do të mbetet në nivelin e mëparshëm prej 45.000 Lek/në vit.
8. **Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore** gjithashtu do të mbetet në të njëjtat nivele. Ajo do t'u kushtojë familjeve vetëm 1800 lekë në vit ose 150 lekë në muaj. Sigurisht, që pensionistët, familjet në ndihmë ekonomike apo shtresat e tjera në nevojë do të përjashtohen nga kjo taksë. Për biznesin kjo taksë do të variojë në bazë të të ardhurave, nga 4000 lekë në vit për biznesin e vogël deri në 37000 lekë në vit për biznesin e madh dhe atë VIP.

Treguesit ekonomikë e financiarë të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019

Treguesit ekonomikë e financiarë të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019, janë bazuar në burimet e planifikuara të PBA-së 2017-2019 dhe në kërkesat e rishikuara buxhetore për këtë periudhë.

Parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve është bazuar në:

- Paketën fiskale aktuale të Bashkisë së Tiranës,
- Shpërndarjen e burimeve në përputhje me prioritetet e zhvillimit të qytetit, përcaktuar në programin e Kryetarit të Bashkisë 2015-2019,
- Prioritetet e qytetarëve të regjistruara gjatë takimeve në çdo njësi administrative,
- Analizën e kostove të shërbimeve për çdo program.

Treguesit ekonomikë e financiarë të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Emërtimi	PARASHIKIMI 2017	PARASHIKIMI 2018	PARASHIKIMI 2019
I	Të ardhura të taksueshme	7,074,590	7,249,500	7,437,060
1	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	1,835,767	1,900,000	1,960,000
a	Familjarët	235,767	250,000	260,000
b	Subjektet Tregtare	1,600,000	1,650,000	1,700,000
2	Taksa mbi token Bujqesore	25,000	27,500	30,000
3	Taksa mbi truallin	45,000	48,000	50,000
4	Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	231,000	250,000	280,000
5	Taksa e fjetjes në hotel	150,000	153,000	156,060
6	Taksa e ndikimit ne infrastructure nga ndertimet e reja	2,700,000	2,730,000	2,750,000
7	Taksambi kalimin e të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	415,000	420,000	425,000
8	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	291,000	300,000	325,000
9	Taksa e tabelës	501,000	516,000	531,000
a	Tabelë identifikuese/sinjalizuese	1,000	1,000	1,000
b	Tabelë reklamuese	500,000	515,000	530,000
10	Taksa e përkohëshme per infrastrukturen Arsimore	880,823	905,000	930,000
	Familjarët	330,823	340,000	350,000
	Subjektet Tregtare	550,000	565,000	580,000
II	Të ardhura jotatimore	4,789,210	4,655,500	4,699,000
1	Tarifat	4,106,710	3,950,000	3,950,000
a	Tarifa e pastrimit	2,422,710	2,280,000	2,350,000
a.1	Familjarët	1,022,710	860,000	900,000
a.2	Subjektet Tregtare	1,400,000	1,420,000	1,450,000
b	Tarifa e parkimit te automjeteve	450,000	500,000	530,000
b.1	Parkim me kontratë	100,000	120,000	130,000
b.2	Parkimmebileta	350,000	380,000	400,000
c	Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	210,000	220,500	235,000
e	Tarifa dhenie licence tregtim karburanti+Lende djegese	400,000	295,000	148,000
f	Tarifa për zënien e hapësirave publike	610,000	639,000	670,000
f.1	Tarifa për zënien e hapësirave publike me platform betoni, kangjella.	530,000	555,000	580,000
f.2	Tarifa për zënien e hapësirave në tregjet publike	80,000	84,000	90,000
g	Tarifa e sherbimit veterinare	6,000	6,500	7,000
h	Tarifa sherbimi te MZSH	8,000	9,000	10,000
2	Të ardhura të tjera	484,500	501,500	538,000
a	Qera ndertese	34,000	37,500	40,000
b	Qera trualli	3,500	4,000	5,000
c	Te tjera	362,000	370,000	400,000
d	Nga institucionet e varesise	85,000	90,000	93,000
3	Pagesa	198,000	204,000	211,000
a	Per kopshtet e femijeve	122,000	125,000	127,000

b	Per çerdhet e femijeve	72,000	75,000	80,000
c	Per Konviktet e Shkollave te Mesme	4,000	4,000	4,000
	Shuma	11,863,800	11,905,000	12,136,060
	Transferta e pakushtezuar	1,913,120	1,951,382	1,990,410
	Te mbartura nga viti 2016	650,000		
	Totali i të ardhurave	14,426,920	13,856,382	14,126,470
I.	Shpenzime Korrente	8,302,103	8,475,711	8,496,711
1	Personeli (Paga dhe Sigurime Shoqerore)	3,640,711	3,640,711	3,640,711
2	Shpenzime per interesa	10,000	10,000	10,000
3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	4,422,892	4,591,500	4,642,500
4	Transferta Individe	189,000	194,000	164,000
5	Transferta të brendshme	39,500	39,500	39,500
6	Transferta jashtë		-	
II.	Fondi Rezervë, Kontigjenca	130,000	140,000	140,000
1	Fondi Rezervë	120,000	120,000	120,000
2	Fond Kontigjence	10,000	20,000	20,000
III	Shpenzime Kapitale	5,994,817	5,240,671	5,489,759
	Financimi Brendshëm	-	-	-
	Totali i shpenzimeve	14,426,920	13,856,382	14,126,470

KAPITULLI IV PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2017-2019

Në vijim të përmbushjes së objektivit për rritjen e standardeve dhe cilësisë së shërbimeve, nëpërmjet rritjes së efencës në menaxhimin e shpenzimeve, buxheti është hartuar bazuar në:

- Zhvillimin e sistemit të planifikimit afatmesëm, në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, si një mjet për integrimin sa më mirë në procesin buxhetor, të objektivave politike e strategjike të Bashkisë së Tiranës;
- Aplikimin e sistemit të buxhetimit me pjesëmarrje, bazuar në konsultimet paraprake me banorët e çdo njësie administrative;
- Forcimin e administratës tatimore dhe rritjen e efencës për realizimin e të ardhurave në kufijtë e kapacitetit;
- Zhvillimin e burimeve alternative të financimit.

Në terma të përgjithshëm programi financiar i Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019 paraqet:

- Parashikimin e të Ardhurave: Parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;
- Parashikimin e Shpenzimeve: Alokimin/shpërndarjen e të ardhurave për vitet në vazhdim për:
 - Shpenzime kapitale sipas programeve të zhvillimit të qytetit,
 - Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes për përmbushjen e funksioneve;
 - Shpenzime personeli;
- Buxheti ka në fokus rritjen e cilësisë së shërbimeve në sektorët prioritarë, shërbime publike, arsim dhe infrastrukturë rrugore;
- Zbatimin e politikave kombëtare për përcaktimin e nivelit të pagave;
- Raporti midis shpenzimeve korente dhe atyre kapitale, arrin respektivisht në 58% me 42%. Krahasimisht me vitin 2016, kur raporti ka qenë respektivisht 61% me 39%; është rritur në favor të shpenzimeve kapitale
- Raporti i burimeve të financimit paraqitet:
 - 87% nga të ardhurat e veta të bashkisë së Tiranës;
 - 13% nga të ardhurat nga buxheti i shtetit (transfera e pakushtëzuar);

IV.1 TË ARDHURAT E BASHKISË SË TIRANËS PËR PERIUDHËN 2017-2019

Burimet e financimit të buxhetit për Bashkinë e Tiranës, përbëhen nga:

- I. Të ardhurat e veta:
 - a) Të ardhurat nga taksat
 - b) Të ardhurat nga tarifatat
 - c) Të ardhurat nga njësitë e varësisë;
- II. Transferta e pakushtëzuar.
- III. Transferta e kushtëzuar;
- IV. Huamarrja e qeverisjes vendore;


Për vitin 2017 është llogaritur që të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore të arrijnë në shumën 13.776.919.744 lekë me një rritje prej 13% në krahasim me parashikimin e vitit 2016. Kjo rritje vjen edhe për arsye të rishikimit të kapacitetit të taksave e tarifave, duke identifikuar me saktësi subjektet që duhet të likuidojnë këto detyrime.

Për vitin 2017, vlera e transfertës së pakushtëzuar akorduar për Bashkinë e Tiranës është në shumën 1.913.119.744 lekë ose 25 % më e lartë se transfertat e pakushtëzuar për vitin 2016, që shprehur në vlerë monetare është 381.660.775 lekë më shumë.

Në vijë të përgjithshme parashikimi i të ardhurave për vitet 2017-2019, paraqitet me këto vlera:

në lekë

	Plani 2016	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Të ardhura të taksueshme	6.582.428.000	7.074.590.000	7.249.500.000	7.437.060.000
Të ardhurat jo tatimore	4.069.000.000	4.789.210.000	4.655.500.000	4.699.000.000
	10.651.428.000	11.863.800.000	11.905.000.000	12.136.060.000
Transferta e pakushtëzuar	1.531.458.969	1.913.119.744	1.951.382.139	1.990.409.781
T o t a l i	12.182.886.969	13.776.919.744	13.856.382.139	14.126.469.781



Mbështetur në legjislacion dhe në vendimin e Këshillit Bashkiak, për mbledhjen e të ardhurave janë përcaktuar edhe strukturat përkatëse, si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
 - Tirana Parking
 - Strukturat e Aparatit të Bashkisë
 - Agjentët tatimor
- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, është struktura kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë së Tiranës, e cila jo vetëm arkëton por dhe monitoron të gjitha strukturat e tjera.
 - Tirana Parking, është struktura e specializuar vetëm për mbledhjen e tarifës së parkimit sipas VKB Nr.48 datë 11.11.2016“Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësie të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”
 - Strukturat e Aparatit të Bashkisë janë të angazhuara në arkëtimin e tarifave të shërbimit që aplikon vetë institucioni si dhe në taksat që zbatohen direkt prej tyre.
 - Agjentët tatimor të përcaktuar sipas ligjit dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, janë:
 - Drejtoria Rajonale Tatimore, për arkëtimin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e BV;
 - DRSHTRR, për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura;
 - ZVRPP, për arkëtimin e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
 - Ujësjellës Kanalizime Sha, për arkëtimin e tarifës së pastrimit nga kategoria Familjarë;

Në mënyrë të detajuar të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për parashikimin e vitit 2017 në Bashkinë e Tiranës, paraqiten si më poshtë:

a) TAKSA MBI PASURINË.

Në vitin 2017, janë parashikuar te ardhura nga taksa ne vlerën 1.835.767.000 lekë.

Në këtë parashikim përfshihen të ardhurat nga kategoria familjare dhe kategoria e biznesit, si më poshtë:

në lekë

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	1.835.767.000	1.900.000.000	1.960.000.000
- Familjarët	235.767.000	250.000.000	260.000.000
- Subjektet Tregtare	1,600,000,000	1,650,000,000	1,700,000,000

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, si një nga strukturat e ngarkuara për mbledhjen e kësaj takse për sa i përket bizneseve, parashikohet që për vitin 2017 numri i njësive të mundshme për arkëtim të jetë 38.488 njësi dhe sipërfaqet aktive për arkëtim të jenë 5.408.306 m², kjo e detajuar sipas kategorive të bizneseve në pasqyrën më poshtë:


Taksa mbi Ndërtesën	Sip. në m²	Nr. njësive
Kategoritë e biznesit	5.501.363	39.347
BV	3.208.120	34.735
BM -VIP	1.390.417	3.676
Prodhimi	294.839	163
Te tjera	607.987	773

Taksa e pasurisë është një nga burimet më me peshë në buxhetin e Bashkisë së Tiranës dhe përbëjnë 17 % të totalit të të ardhurave të veta.

Gjatë viteve 2015 dhe 2016 kjo taksë ka arritur nivelet maksimale të arkëtimit, veçanërisht për kategorinë biznese. Për këtë kategori, performanca është 84% më të lartë se në vitin 2014 dhe 204% krahasimisht me vitin 2013.

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Takse mbi pasurinë e paluajtshme	349,688,817	394,890,918	432,626,374	420,291,959	419,427,728	366,911,540	470,933,202	454,888,646	756,756,097	812,156,476	1,455,611,610
Familjare	18,350,654	40,008,019	47,311,969	28,411,901	16,275,705	9,987,264	13,765,827	14,174,707	29,918,994	16,879,527	116,557,156
Biznesi	331,338,163	354,882,899	385,314,406	391,880,058	403,152,023	356,924,276	457,167,375	440,713,939	726,837,103	795,276,949	1,339,054,454

Grafikisht:



Pas vendimit të Bashkisë për përzgjedhjen e UKT Sh.a si agjent tatimor për mbledhjen e taksave të familjarëve, ka një përmirësim të ndjeshëm gjatë vitit 2016 edhe për këtë kategori, duke shënuar sërish nivelin më të lartë të arkëtimit në 15 vitet e fundit, me një performancë 7 herë më të lartë se në vitin 2015.

Bashkia e Tiranës është duke punuar për të zgjidhur brenda vitit 2017 sfidën disavjecare të sigurimit të bazës e dhënave të pronave të paluajtshme të familjeve në Tiranë, e cila do të mundësojë arkëtimin e plotë të kësaj takse dhe përmirësimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitet në vijim.

Për kategorinë Familjare, nga UKT Sh.a është parashikuar që nga numri mesatar për vitin 2017 prej 204.800 familje të kontraktuara të arkëtohen 196.600 familje për vlerën 235.767.000 lekë e detajuar kjo për ndërtesat në zonë rurale dhe rajonale.

Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse, DPTTV dhe agjenti tatimor UKT Sha, do të vijonë përkushtimin në rrugën e nisur për konsolidimin e bazës së të dhënave për taksapaguesit dhe shmangien e evazionit fiskal.

b) TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nën kategorizime.

Si rezultat i reformës administrativo – territoriale, Bashkisë së Tiranës i janë shtuar edhe sipërfaqe toke bujqësore.

Vlera e taksës në lekë/hektar/vit sipas kategorive paraqitet në tabelë:

Kategoritë e tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	5 600
II	4 900

III	4 200
IV	3 600
V	3 000
VI	2 400
VII- X	1 800

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, në parashikimin për vitin 2017 ka evidentuar 10.181 m² tokë bujqësore dhe një numër 7.034 njësi, të detajuara sipas kategorisë së tokës. Për vitin 2017 janë parashikuar të ardhura nga kjo taksë në shumën 25.000.000 lekë, kjo e mbështetur në llogaritjet mbi bazën e sipërfaqes së tokës dhe nivelit të taksës për çdo kategori toke.

Parashikimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore për vitet 2017-2019, paraqitet si më poshtë:

Ne leke

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Taksa mbi tokën Bujqësore	25,000,000	27,500,000	30.000.000

c) TAKSA MBI TRUALLIN

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m², në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në tabelën e mëposhtme.

Në vitin e parë të aplikimit të kësaj Takse, sipas ndryshimeve ligjore të vitit 2015, Bashkia e Tiranës ka arkëtuar 176% të planifikimit vjetor për vitin 2016. Për këtë arsye planifikimi për vitet e ardhshme është parashikuar rreth 2 herë më i lartë se në 2016.

Per vitin 2017 dhe dy vitet ne vijim 2018-2019, parashikimi te ardhurave nga kjo taksë jepet në tabelë:

në lekë

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Taksa mbi truallin	45,000,000	48,000,000	50.000.000

d) TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL.

Çdo biznes, i cili realizon gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore të cilat transferojnë të ardhurat nga TTHF e biznesit të vogël në llogarinë e Bashkisë së Tiranës sipas afateve të përcaktuara në ligj.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, si strukture e ngarkuara për mbledhjen e tatimit tte Thjeshtuar mbi Fitimi te BV, e filloi këtë detyre ne vitin 2014 e vijon dhe rezultatet tregojnë se është rritur ndjeshëm numri i subjekteve të evidentuar si BV.

Bazuar ne pritshmërinë e vitit 2016, parashikimi për vitet 2017-2019 dhe sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane me nr. 65442/1 datë 17.11.2016, paraqitet si më poshtë:

në lekë

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	231.000.000	250.000.000	280.000.000

e) TAKSA PËR FJETJEN NË HOTEL.

Subjekt i kësaj takse janë bizneset që kryejnë aktivitete të tilla si:

- Hotelet, motelet,
- Stabilimentet turistik, pensionet,
- Shtëpitë e pritjes, turizmi familjar,
- Çdo objekt tjetër që përdoret për këtë veprimtari.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore. Llogaritja e kësaj takse, bazuar në legjislacionin në fuqi, bëhet sipas ndarjes në dy kategori:

- Njësi ku taksa është 140lekë/dhoma
- Njësi ku taksa është 350lekë/dhoma

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, numri i njësive ku taksa është ne nivelin 140 lekë/dhoma është 228 subjekte që zhvillojnë aktivitetin në Bashkinë e Tiranës, ndërsa vetëm 4 subjekte preken nga niveli i taksës 350 lekë/dhoma. Në varësi të vlerësimit që pritet t'u bëhet bizneseve që zhvillojnë këto lloj aktivitete, mund të ndryshojë edhe numri i tyre për secilën kategori të kësaj takse.


Parashikimi i të ardhurave nga taksa e fjetjes ne hotel për vitet 2017-2019, është si me poshtë:
ne leke

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Taksa e fjetjes në hotel	150,000,000	153.000.000	156.060.000

Performanca e realizimit ndër vite për këtë taksë është e lidhur kryesisht me luhatjet e nivelit të taksës. Megjithë bllokimin për një periudhë të vitit gjatë 2016, për arsye të interpretimeve ligjore për aplikimin e taksës, (taksa është e aplikueshme në bazë të yjeve, ndërkohë që nuk kishte ende një kuadër/legjislacion për yjet e hoteleve), është shënuar një rritje prej 132% në krahasim me arkëtimet e vitit 2015 dhe 160% në krahasim me ato të vitit 2014.

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Taksa e fjetjes në hotel	55,053,115	68,839,314	70,659,966	70,209,593	83,463,563	80,617,031	46,329,950	39,845,616	42,060,817	50,480,613	66,746,131

Grafikisht:



f) TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit i nënshtrohen të gjitha subjektet që kërkojnë të pajisen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi për objekte banimi, administrative, prodhimi, shërbimi e tjera.

Niveli i taksës është 4% – 8% e vlerës së investimit e llogaritur sipas çmimit referues.

Arkëtimi saj për vitet 2015-2016 dhe parashikimi për vitin 2017, është si më poshtë:

në lekë

	Fakti 2015	I pritshmi 2016	Parashikimi 2017
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	128.325.090	2.160.000.000	2.700.000.000

Nisur dhe nga fakti që brenda vitit 2016 përfundon dhe miratohet edhe plani rregullues i Tiranës, për vitet 2017-2019, parashikimi nga kjo taksë, paraqitet:

në lekë


	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	2.700.000.000	2.730.000.000	2.750.000.000

Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë që pranon kërkesat, shqyrton ato dhe mbas miratimit nga Titullari, kryejnë edhe zbardhjen e kësaj leje kundrejt arkëtimit me parë të vlerës në masën sipas përcaktimeve ligjore.

Krahasuar me vitet 2012-2014 vihet në dukje se realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është mbi 4 herë më shumë se viti 2012, rreth 87% më shumë se viti 2013 dhe 17% më shumë se viti 2014. Edhe ndaj viteve të mëparshëm realizimi i vitit 2016 është dukshëm më i lartë, si më poshtë:

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Taksa e ndikimit ne infrastrukturë nga ndertimet e reja	716,060,770	199,080,676	898,015,065	853,767,066	165,841,309	435,469,658	245,071,462	624,719,373	1,004,842,547	128,325,090	1,272,832,096

Grafikisht:



Sikurse tregojnë të dhënat, viti 2016 evidentohet si viti më i suksesshëm për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, duke arritur vlerën më të lartë të arkëtuar në 15 vitet e fundit.

g) TAKSA E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME.

Realizimi i kësaj takse realizohet nga strukturat e ZVRPP, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arkëtuar.

Të dhënat për parashikim e kësaj takse merren nga ZRRPP e cila finalizon dhe evidenton të gjitha rastet e transkriptimit të pronës duke llogaritur detyrimin si për llojin e pronësisë por dhe vlerën e detyrimit mbi bazën e sipërfaqes së taksueshme. Kështu detyrimi për banesat është në nivelin 1.000 lekë m² dhe për objektet e biznesit është 2.000 lekë m². Numri i objekteve që transkriptohen është e lidhur ngushtë me lejet e shfrytëzimit të lëshuara nga njësitë vendore për objektet e përfunduara por dhe nga ALUIZNI për ato të legalizuara. Eksperienca e ZRRPP në bashkëpunim me strukturat vendore, mundëson edhe një parashikim sa më real të taksës mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Bazuar në këto nivele të taksës janë kryer dhe kalkulimet për parashikimin e saj për vitet 2017 në veçanti dhe vitet në vijim 2018-2019 , si më poshtë:

	në lekë		
	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	415,000,000	420,000,000	425,000,000

h) TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA

E ardhura nga taksa, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Tirane) para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësisve të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 18 % e të ardhurave vjetore mbasi është zbritur vlera e 5% që i takon agjentit tatimor DPSHTRR.

Në të dhënat e bëra prezent nga DRSHTRR e cila evidenton numrin e mjeteve dhe detyrimin e tyre në momentin që paraqiten për kolaudim. Niveli i taksës parashikohet duke marrë në konsideratë fuqinë motorike dhe vjetërsinë e mjetit. Nisur nga praktikat dhe pritshmëria e mjeteve për kolaudim bëhet e mundur edhe parashikimi i të ardhurave për periudhën në vijim. Kjo pritshmëri është e lidhur dhe me politikat shtetërore mbi lehtësirat fiskale ndaj disa kategori mjeteshe, rritjen e kërkesave ndaj mjeteve në qarkullim me qëllim mos ndotjen e mjedisit si dhe rritjen e detyrimit për mjetet e luksit me fuqi të madhe motorike.

Parashikimi për vitet 2017-2019, është si vijon:

	në lekë		
	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	291.000.000	300.000.000	325.000.000

i) TAKSA E TABELËS.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve, subjekteve të transportit dhe profesionet e lira.

Taksa e tabelës përbëhet :

- Tabelë për qëllime identifikimi
- Tabele për qëllime reklamimi

Taksa e tabelës për qëllime identifikuese ndahet ne:

- Tabelë për qëllime identifikimi:
- Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:
- Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

Mbështetur në realizimin e viteve të mëparshme por dhe në ecurinë e arkëtimit të kësaj takse, janë kryer edhe evidentimet mbi subjektet e kësaj takse. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore kemi këtë shpërndarje të subjekteve pages:

Taksa e Tabelës	Sipërfaqe m²	Nr. njësi biznesi
	8.510	2.235
Tabele identifikuese/sinjalizuese	16	6
Tabele me qëllim identifikimi mbi 2 m ²	34	12
Tabelë reklamimi e thjeshtë		
zona rreth qytetit	8,125	2.231
zona larg qytetit	78	24
Tabelë reklamimi elektronike		
zona rreth qytetit	257	62
zona larg qytetit		

Konkretisht, kundrejt të pritshmit të të ardhurave për vitin 2016, numrit të subjekteve të evidentuara dhe nivelit të taksës së miratuar sipas ligjit, parashikimi i të ardhurave për vitet 2017-2019, paraqitet në tabelë si më poshtë:

në lekë

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Taksa e tabelës	501.000.000	516.000.000	531.000.000
- Tabelë identifikuese	1.000.000	1.000.000	1.000.000
- Tabelë reklamuese	500.000.000	515.000.000	530.000.000

Strukturat e DPTTV vijnë angazhimin maksimal për verifikimin në gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës lidhur me vendosjen e tabelave dhe sipërfaqet e tyre duke qenë se ndryshimi i nivelit

të kësaj takse ka bërë që disa biznese të rishikojnë sipërfaqen e tabelave që përdorin për qëllime reklamimi.

Taksa e tabelës, ku përshihen Tabela identifikuese dhe ajo e reklamës kanë specifikat e veta si në nivelin e tyre por dhe në rikonceptim. Kështu taksa e tabelës identifikuese deri në 2 m² është zëruar por për sipërfaqe mbi 2 m² ka barazuar nivelin e reklamës së thjeshtë. Për këto arsye, numri i madh i tabelave nën 2 m² ka ndikuar edhe në arkëtimin prej saj, ku rezultatet e këtij viti janë shumë herë më të ulta se në vitet e mëparshme. Në këtë kategori mbetet vetëm tabela identifikuese/ sinjalizuese me nivelin e saj 120 lekë në vit që aplikohet për të treguar vendndodhjen e biznesit.


Ndryshe pasqyrohet situata për tabelat reklamuese e cila reflekton nivele të diferencuara për reklamat e thjeshta nga ato elektronike, rezultatet e të cilës edhe se disi në rritje në vlerë absolute, krahasuar me vitet e tjera është ende larg objektivit.

Ecuria e taksës së tabelës ndër vite pasqyrohet si më poshtë:

Në lekë

	Fakti 2007	Fakti 2008	Fakti 2009	Fakti 2010	Fakti 2011	Fakti 2012	Fakti 2013	Fakti 2014	Fakti 2015	Fakti 2016
Taksa për tabelën	68,017,647	94,348,420	150,436,049	244,343,219	256,255,900	264,762,861	241,190,949	227,080,832	225,377,938	306,746,123
Tabelë	31,485,255	37,432,098	39,538,500	6,499,688	3,712,441	3,495,455	3,587,992	4,224,923	4,409,354	941,762
Reklame	36,532,392	56,916,321	110,897,549	237,843,531	252,543,459	261,267,406	237,602,957	222,855,909	220,968,584	305,804,361

Grafikisht:



Sërish, viti 2016 shënon nivelin më të lartë të arkëtimeve nga kjo taksë për 15 vitet e fundit me një performancë 1385 më të lartë krahasimisht me vitet 2014 dhe 2015.

j) TAKSA E PËRKOSSHME PËR INFRASTRUKTURËN ARSIMORE

Taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Të ardhurat nga kjo taksë e përkohshme do të përdoren me qëllimin për të cilën është vendosur, për rikonstruksionin e objekteve arsimore, shkolla e kopshte si dhe të infrastrukturës arsimore të Bashkisë së Tiranës e cila e ka të domosdoshme ndërtimin e shkollave e kopshteve të reja por dhe ndërhyrjet për rikonstruksionin e atyre ekzistuese.

Për periudhën 2017-2019, parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë e përkohshme, është si vijon:

	Njësi aktive të tarifuar	Vlera e detyrimit
Taksa e përkohëshme për infrastrukturën Arsimore	58.468	550.000.000
Njësi BV	38.096	169.872.000
Njësi BM	13.892	263.948.000
Njësi VIP	4.189	104.725.000
Njësi të Tjera + Shtetërore	2.291	11.455.000

Nga UKT Sha është parashikuar që kjo taksë të arkëtohet nga 177.800 familje kundrejt 204.800 familje të kontraktuara dhe duke marrë në konsideratë edhe 27.000 familje që përfitojnë nga lehtësirat fiskale dhe për tre vitet e parashikimit 2017- 2019 si më poshtë:

Në lekë

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Taksa e përkohëshme për infrastrukturën Arsimore	880.823.000	905.000.000	930.000.000
-Familjarët	330.823.000	340.000.000	350.000.000
-Subjektet Tregtare (BV = 0)	550.000,000	565.000.000	580.000.000

k) TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE.

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave mblihet nga dy struktura, përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për kategorinë e biznesit dhe Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë Sha për kategorinë familjarë.

Referuar realizimit të kësaj tarife ndër vite dhe kapacitetit të taksapaguesve, për vitet 2017-2019 do të kemi parashikimet e mëposhtme. Për vitin 2017 parashikimi paraqitet më i lartë për arsye se gjatë këtij viti do të arkëtohet tërësisht borxhi i trashëguar, që UKT sh.a i detyrohet Bashkisë së Tiranës për arkëtime të munguara në vite përpara vitit 2015.

në lekë

	Plani Vitit 2016	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Tarifa e pastrimit	2.175.000.000	2.422.710.000	2.280.000.000	2.350.000.000
- Familjarët	795.000.000	1.022.710.000	860.000.000	900.000.000
- Subjektet Tregtare	1.380.000.000	1.400.000.000	1.420.000.000	1.450.000.000

Parashikimi i të ardhurave nga subjektet e biznesit është mbështetur në kapacitetet e taksapaguesve që përfaqësojnë numrin e subjekteve të evidentuara aktiv dhe nivelit të tarifës për vitin ushtrimor, të ardhura që trajtohen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila në bashkëpunim me njësitë administrative do kryejnë në kohë njoftimet e subjekteve për detyrimin por në veçanti të ndjekin dhe mbledhjen e tyre.

Tarifa e pastrimit për kategorinë familjare do të vijojë të arkëtohet nga Ujësjetës Kanalizime Sha i cili ka parashikuar një numër mesatar prej 177.800 familje efektivisht të mundshme për tu kontraktuar dhe arkëtuar tarifën e pastrimit nga 204.800 familje të evidentuara, me nivele të diferencuara për qytetin dhe njësitë administrative, duke marrë në konsideratë edhe lehtësirat fiskale për 27.000 familje të kategorisë që plotësojnë kushtet e VKB, për përjashtim nga pagesa e saj.


Agjenti tatimor, e ka përfshirë tarifën e pastrimit për familjarë në faturën e ujit dhe për çdo muaj krahas vlerës së përdorimit të ujit ka arkëtuar edhe tarifën e pastrimit nga çdo familja që ka kontratë dhe konsum uji, duke përjashtuar familjet që përfitojnë lehtësira fiskale sipas kërkesave të vendimit të Këshillit Bashkiak.

Ecuria e arkëtimit të tarifës së pastrimit për kategorinë Familjarë ka pësuar një rritje të dukshme sidomos në vitin 2016, për gati dy herë më shumë se arkëtimet e periudhës 2012-2015 dhe disa herë më shumë se në vitet 2006 -2011. Ndërkohë edhe arkëtimet nga kategoria Subjekte ka arritur të realizohet për rreth 2 herë më shumë se çdo vit të periudhës 2006-2015, kjo në sajë të rritjes së numrit të taksapaguesve rrjedhojë e reformës administrativo-territoriale por dhe riorganizimit të strukturave mbledhëse, si më poshtë:

në lekë

	Fakti 2006	Fakti 2007	Fakti 2008	Fakti 2009	Fakti 2010	Fakti 2011	Fakti 2012	Fakti 2013	Fakti 2014	Fakti 2015	Fakti 2016
Tarifa e pastrimit	316,027,081	411,030,847	591,209,154	616,909,025	489,809,864	465,399,307	775,944,605	755,099,878	809,739,138	831,665,045	1,602,556,902
Familjare	31,615,240	73,920,319	159,981,047	131,260,212	68,837,625	49,004,088	324,127,250	337,189,756	339,808,610	353,205,579	680,146,260
Subjekte	284,411,841	337,110,528	431,228,107	485,648,813	420,972,239	416,395,219	451,817,355	417,910,122	469,930,528	478,459,466	922,410,642

Grafikisht:



I) TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE.

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m2 të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit e indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj
- Zënia e hapësirës publike ne tregjet publike.
- Zënia e hapësirës publike për organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme

Tarifa për Zënien e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj planifikohet dhe arkëtohet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, për çdo rast të zënies dhe përdorimit të hapësirave publike në territorin e qytetit dhe është një taksë mujore kundrejt nivelit të taksës sipas ndarjes zonale.

Ndërkohë, edhe Tarifa për Zënien e hapësirës publike në tregjet publike, mblihet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me strukturat e Njësive Administrative sipas shtrirjes zonale të tregjeve publikë.


Mbi këtë bazë janë parashikuar edhe të ardhurat e kësaj tarife për vitet 2017-2019, është si më poshtë:

në lekë

	Plani Vitit 2016	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Tarifa për zënien e hapësirave publike	680.000.000	610.000.000	639.000.000	670.000.000
-Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni,kangjella.	600.000.000	530.000.000	555.000.000	580.000.000
-Tarifa për zënien e hapësirave në tregjet publike	80.000.000	80.000.000	84.000.000	90.000.000

Arkëtimet nga tarifa e zënies së hapësirës publike janë 3 herë më të larta se arkëtimet e vitit 2015 dhe thuajse 4 herë më të larta se ato të vitit 2014.

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Taksa per zenien e hapësirave publike	50.978.563	51.800.814	47.556.918	48.757.714	48.939.033	58.758.781	56.894.544	60.465.809	65.713.463	271.012.385



m) TARIFA E PARKIMIT.

Tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia e Tiranës për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, atyre të rezervuara dhe për taksitë e licensuara.

Reforma administrativo-territoriale dhe problematikat që kanë shoqëruar trajtimin e parkimit në Tiranë, diktuan krijimin e një institucioni varësie të emërtuar “Tirana Parking”, si një institucion i specializuar dhe i fokusuar në çështjet e parkimit.

Me qëllim evidentimin dhe ndjekjen operacionale të parkimit, territori i Bashkisë Tiranës është detajuar në zona tarifore sipas tipologjive, me qëllim vendosjen dhe vjeljen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë – mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre.

Zona A	Tarifa për parkim në rrugë	100 Lekë /ora
Zona B	Tarifa për parkim në rrugë	40 Lekë/ora
Zona C	Tarifa për parkim në rrugë	20 Lekë /Ora

Krahas kësaj tarife në vendparkime të veçanta në rrugë, do aplikohen edhe nivele tarife të ndryshueshme për sheshe të miratuara dhe vendparkime me rezervim kryesisht në rrugë, në shërbim të subjekteve biznesi dhe institucioneve shtetërore.

Siç shihet edhe nga të dhënat, realizimi të ardhurave të tarifës së parkimit ka qenë në nivele të ulta, dhe për këtë qëllim u ngrit struktura e specializuar që me funksionimin e saj të mundësojë një rritje të ndjeshme të të ardhurave prej kësaj tarife, sipas parashikimeve për vitet 2017-2019, si më poshtë:

në lekë

	Fakti Vitit 2015	Plani Vitit 2016	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Tarifa e parkimit te automjeteve	71,628,038	300,000,000	450.000.000	500.000.000	530.000.000
-Parkim me kontratë	53,843,438	50,000,000	100.000.000	120.000.000	130.000.000
-Parkim me bileta	17,784,600	250,000,000	350.000.000	380.000.000	400.000.000

Krahasuar me vitet e kaluara, arkëtimi i tarifës së parkimit për vitin 2016 ka një rritje të dukshme, si rrjedhojë e riorganizimit të strukturave, mënyrës së arkëtitimit dhe evidentimit në kohë të përdoruesve të parkimit në rrugët me pagesë por dhe në sheshet e miratuara për parkim, si më poshtë:

2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
36,352,654	48,975,233	61,633,912	79,733,216	74,937,653	68,449,398	78,011,313	76,242,781	67,899,565	71,628,038	192,241,790

Grafikisht:



n) TARIFA PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PUNIME.

Tarifa paguhet në masën 1% të vlerës së investimit, për çdo aplikim për leje zhvillimi, infrastrukturë dhe ndërtimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Parashikimi i Tarifës për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime është kryer përafërsisht si parashikimi i vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit sa 1% e investimit për çdo leje shumëzuar me sipërfaqen e parashikuar për shfrytëzim me objekte ndërtimore sipas planit rregullues.

Në këtë mënyrë, parashikimi për vitet 2017-2019 paraqitet si më poshtë:

Ne leke

	Fakti Vitit 2015	Plani Vitit 2016	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	2,658	200.000.000	210.000.000	220.000.000	235.000.000

o) TARIFA PËR DHËNIE LICENCE PËR TREGTIM KARBURANTI E LËNDË DJEGËSE.

Tarifa për dhënien e licencave të tregtimit të karburantit dhe lëndëve djegëse është detyrim për të gjitha pikat e tregtimit fundor në territorin e Bashkisë Tiranë.

Qëllimi i miratimit të kësaj tarife është rregullimi i tregut të karburanteve dhe lëndëve djegëse, për një shpërndarje racionale dhe një mirë administrim të territorit duke shmangur ngritjen e

pikave të tregtimit të tyre në afërsi të ndërtesave të banimit, qendrave arsimore dhe institucioneve.

Për vitet 2017 – 2019 është parashikuar që të ardhurat të arrijne shifrat si më poshtë:

Ne leke

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Tarifa për dhenie licence për tregtim karburati e lëndë Djegëse	400.000.000	295.000.000	148.000.000

Unioni i Shoqërive Hidrokarbure të Shqiptare, në muajin qershor 2016 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. Pezullimin e zbatimit të pikës 9 të Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” deri në përfundim të gjykimit; dhe me palë të interesuar, Këshilli i Ministrave.

Gjykata Kushtetuese, pasi morri në shqyrtim kërkesën e mësipërme vendosi pranimin pjeserisht të saj duke shfuqizuar pikën 9 të kreut II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pikë e cila parashikonte tarifën për pajisje me licencë për stacionet e shitjes së karburanteve.

Aktualisht është duke u rishikuar kuadri ligjor/rregullativ dhe për vitin 2017, parashikohet të fillojë arkëtimi i kësaj takse.

p) TË ARDHURA NGA PAGESAT PËR KOPSHTE, ÇERDHE E KONVIKTE.

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila përbëhet nga tarifa për ushqimin që llogaritet me tarifën ditore dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë një muaji.

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila përbëhet vetem nga tarifa për ushqimin, kjo llogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe/kopsht gjatë muajit.

Parashikimi i të ardhurave për vitet 2017-2019, synon shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve akomoduese me kushte optimale të funksionimit por dhe për përmirësimin e shërbimit në trajtimin e fëmijëve.

Referuar këtyre kërkesave, parashikimi i të ardhurave, prezantohet si më poshtë vijon:

në lekë

	Fakti Vitit 2015	Plani Vitit 2016	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Pagesa për kopshtet e fëmijëve	114,242,018	120,000,000	122,000,000	125,000,000	127,000,000
Pagesa për çerdhet e fëmijëve	55,788,948	70,000,000	72,000,000	75,000,000	80,000,000

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.

Përsa i përket pagesës për konviktet e Shkollave të mesme, parashikimi i të ardhurave për vitet 2017-2019, duke evidentuar dhe faktin e vitit 2015, si dhe planin për vitin 2016, paraqitet si më poshtë:

Në lekë

	Fakti Vitet 2015	Plani Vitet 2016	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Pagesa per Konviktet e Shkollave te Mesme	3.005.580	4.000.000	4.000.000	4.000.000	4.000.000

IV.2 TRANSFERTAT NGA BUXHETI I SHTETIT

Niveli i transfertës së kushtëzuar dhe të pakushtëzuar përcaktohet çdo vit në ligjin e Buxhetit të Shtetit.

Transferta e Pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2017, është në masën 1.913.119.744 lekë, me një rritje prej 25%, krahasimisht me vitin e mëparshëm. Transferta përbën 14% të të ardhurave për vitin 2017. Për periudhën 2018-2019, transferta e pakushtëzuar, referuar parashikimeve të Ministrisë së Financave, do të rritet me 2 % në vit.

Transferta e Kushtëzuar

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njërive vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë:

- *Shërbimi i gjendjes civile* si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime bëhen nga komunat dhe bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve më të detajuara që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Brendshme.
- *Qendrat e Rregjistrimit të Bizneseve*, si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative bëhet nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve që bëhen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
- *Përkrahja sociale*, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë.

Transferta Specifike

Në vitin 2016 njësitë vendore ju transferuan disa funksione të reja, shpenzimet e të cilave do të përballohen nga Transferta specifike akorduar me ligjin për Buxhetin e Shtetit.

Funksionet që financohen me transferta specifike për vitin 2016, janë si më poshtë:

- Konviktet e arsimit parauniversitar
- Arsimi Parashkollor
- Arsimi Parauniversitar
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH)
- Administrimi i pyjeve
- Rrugët rurale
- Ujitja dhe Kullimi

Edhe gjatë vitit 2017, funksionet e transferuara mbeten të njëjtat dhe informacion me të detajuar në lidhje me fondet sipas cdo funksioni mund të gjendet në pasqyrën nr. 3/2 pjesë përbërëse e vendimit.

IV.3 PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 2017-2019

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019, për të gjitha funksionet parashikohen respektivisht në masën 14,426,919,742 lekë, 13,856,382,139 lekë dhe 14,126,469,781 lekë.

Në parashikimet e vitit 2017 është përfshirë edhe fondi që do të mbartet nga viti 2016. Fondet e mbartura përbëjnë fondet e papërdorura në vitin respektiv të arkëtimit të tyre.

Mospërdorimi i këtyre fondeve ka ardhur si rezultat i faturimeve të grumbulluara në ditët e fundit të vitit, të cilat ka qenë e pamundur të procesohen brenda 2016 për shkak të ngarkesës së fundvitit në Degën e Thesarit dhe do të procesohen në muajin janar 2017.

Në periudhë afatmesme:

- Raporti mes shpenzimeve korente dhe atyre kapitale është respektivisht 58% me 42% për vitin 2017. Në periudhë afatmesme synohet rritja e këtij raporti në favor të investimeve çdo vit. Mesatarisht për 3-vjeçarin e parashikimit, peshat e shpenzimeve kryesore janë:

	2016	2017-2019
- Shpenzime personeli	25%	25%
- Shpenzime operative	36%	34%
- Investime	39%	41%

Në vijim paraqitet analiza sipas artikujve e shpenzimeve buxhetore për periudhën e parashikimit 2017-2019.

II.4.1 Shpenzimet kapitale

Për vitin 2017 fondi total për shpenzime kapitale është në shumën 5,994,816,861 lekë ose 41.6% ndaj totalit të shpenzimeve. Për vitet 2018 dhe 2019, buxheti i investimeve parashikohet respektivisht 5,240,671,256 lekë dhe 5,489,758,899 lekë

Ky është buxheti më i madh i investimeve në historinë e Bashkisë së Tiranës. Me një rritje prej 18% në krahasim me investimet e vitit 2016, ky buxhet investimesh është 4 herë më i madh se buxheti faktik i investimeve të vitit 2015.

Tabela më poshtë paraqet fondin e shpenzimeve kapitale për vitin 2017, sipas programeve buxhetore

Në mijë lekë

Nr.	Programi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	Shërbimet Publike Vendore	1,553,730	1,026,427	1,058,679
2	Menaxh. i Rrugëve dhe Transportit Publik	2,353,273	2,169,340	2,255,672
3	Arsimi Parauniversitar dhe Edukimi	1,109,857	912,355	904,108
4	Kujdesi Social	88,072	33,048	164,712
5	Strehimi dhe Planifikimi i Territorit	498,529	815,061	950,633
6	Kultura dhe Turizmi	48,770	16,268	55,955
7	Zhvillimi i Rinisë dhe Sportit	20,936	21,000	50,000
8	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	270,548	247,172	50,000
9	Rendi dhe mbrojtja civile	51,060	-	-
10	Mbrojtja nga zjarri	43	-	-
	TOTALI	5,994,817	5,240,671	5,489,759

II.4.2 Shpenzimet Korente

Shpenzimet korente të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019 parashikohen respektivisht në vlerat 8,432,102,883 lekë, 8,615,710,883 lekë dhe 8,636,710,883 lekë. dhe përbëjnë 58.4% të totalit të shpenzimeve të parashikuara.

Shpenzimet korente përbëhen nga:

- Shpenzimet e personelit,
- Shpenzimet operative për realizimin e funksioneve kryesore,
- Shpenzimet për interesat e kredive,

- Fondi rezervë dhe fondi i kontigjences
- Transfera për buxhete familjare dhe individë (Bonuse, mbështetje sociale, mbështetje të tjera ndaj kategorive të caktuara)
- Transferime korente jashtë

Më poshtë paraqiten shpenzimet korente sipas llojit dhe peshat e specifike:

Në mijë lekë

Nr.	Shpenzimet	2017	2018	2019
1	Shpenzime personeli	3,640,711	3,640,711	3,640,711
2	Shpenzime operative	4,422,892	4,591,500	4,642,500
3	Transferime korente të brendshme	39,500	39,500	39,500
4	Shpenzime për interesa	10,000	10,000	10,000
5	Fondi rezervë dhe fondi i kontigjences	130,000	140,000	140,000
6	Transf.për buxhete familjare dhe individë	189,000	194,000	164,000
TOTALI		8,432,103	8,615,711	8,636,711

1. Shpenzime për Personelin

Në buxhetin e shpenzimeve të personelit për vitin 2017 e në vijim është parashikuar rritja e pagave si rrjedhojë e politikave të reja të pagave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare që do të aplikohen në fillim të vitit që vjen.

Pjesa dërrmuese e ndryshimit në parashikimin e shpenzimeve të personelit për vitin 2017, është si pasojë e këtyre politikave. Një efekt i ndjeshëm në rritjen e parashikimeve për këto shpenzime vjen si rezultat i përllogaritjeve mbi pagën minimale të aplikueshme në administratën publike e cila, sipas parashikimeve të Qeverisë, pritet të rritet ndjeshëm, duke afektuar në mënyrë të dallueshme Bashkinë e Tiranës, për shkak të numrit të punonjësve që preken nga ky ndryshim. Ndërkohë, për vitet 2018 dhe 2019 parashikimet mbështeten në të njëjtin nivel pagash dhe numër punonjësish si ai i vitit 2017.

Bazuar në rezultatet e punës së vitit 2016, performancën dhe administrimin e të ardhurave vendore, shtimin e aktiviteteve dhe arritjen e të gjitha objektivave e prioriteteve të vendosura për vitin 2017, është parashikuar që numrat e punonjësve të strukturave organizative të Aparatit të Bashkisë Tiranë dhe disa prej instiucioneve të varësisë të pësojnë një ndryshim.

Ky miratim është i nevojshëm duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Rritjen e efijencës dhe e performancës së strukturave organizative.

- Përmirësimin e procedurave dhe respektimin e afateve procedurale.
- Përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.
- Koordinimin e administrimit territorial.
- Realizimin e plotë të objektivave.
- Maksimizimin e luftës kundër evazionit fiskal.

Në Aparatin e Bashkisë së Tiranës dhe tek Njësitë Administrative do të shtohen në total 6 punonjës nga të cilët 4 do të jenë në Aparatin e Bashkisë së Tiranës dhe 2 në Njësitë Administrative.

Efektet financiare të aplikimit të nivelit të ri të pagave dhe të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2017, për BT janë 7,438,000 Lekë.

APR

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit (APR) është krijuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 41, datë 23.09.2015 për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, dhe në pikën 2, përcakton detyrat funksionale si:

- a) administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve memoriale (Varrezat e Dëshmorëve Tiranë dhe Pezë) brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
- b) zhvillimi, administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve rekreative (përfshirë parkun zoologjik), historike dhe natyrore brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
- c) kthimi i parqeve, nëpërmjet planifikimit dhe projekteve, në zona rekreative të frekuentueshme nga çdo grup moshe.
- d) mbrojtja e kursorave të gjelbra dhe inspektimi i respektimit të zonave të gjelbra brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Struktura e APR ka aktualisht një numër të përgjithshëm prej 246 punonjësish. Propozohet një shtim prej 25 punonjësish për sektorët dhe arsyet e mëposhtme:

1. Për vitin 2017 është parashikuar shtimi i pikave të grumbullimit dhe trajtimit të funksioneve të transferuara të Pyjeve dhe Kullotave për grumbullimin, shitjen, magazinimin, transportim, prodhim, mbareshtim, azhurnime, monitorim e inspektimet ne Parqe dhe kërkohet një shtesë : **7 punonjës.**

2. Mbarimi i investimeve të Fushave të reja Sportive në PMLAT, mbarimi i punimeve për objektet sanitare, mbarimi i punimeve për objektet rekreative (faza 1 me 7 objekte) që do jenë 24 orë të hapura e në shërbim të publikut, nisja e funksionimit të Trenit tek Parku i Lodrave, administrimi i plotë i vetë Parkut të Lodrave, nisja e administrimit të 2 palestrave të reja të hapura brenda Parkut, administrimi i Teatrit Veror dhe ambjentet në të si dhoma zhveshjeje edhe

për sportet, marrja nga APR e gjithë sipërfaqes së Parkut Olimpik (ish Dinamo) me objekte e mirëmbajtje, bëjnë të domosdoshme personel shtesë si vijon: **13 Punonjës**

3. APR në administratë për të përballuar tërë parashikimet, ngarkesën, punën që del në lidhje me aplikacionet online, Tirana Ime Outdoor, WEB, PR, si edhe ATELIER ku ngarkesa është trefishuar me projektet e Luaj Tirana dhe me Rikualifikimet, si edhe për Logjistikën ku janë shtuar automjetet dhe detyrat, emergjencat e aksionet dhe ndërhyrjet e shumta në terren e në sheshe ku APR bashkëpunon me 3 drejtoritë e tjera të BT si edhe për funksione e detyra të Pyje e Kullotave, Inspektimit, Aktivitete të shumta rekreative në zona rurale e natyrë, transporte e evente, evadime e aksione per qendren, pemet, mbjellje e Pyllin Orbital, etj, jane të domosdoshme shtesat: **5 punonjës.**

Efektet financiare të aplikimit të nivelit të ri të pagave dhe të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2017, për APR, do të jenë 13,234,000 Lekë

DPTTV

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) ka si funksion të saj mbledhjen e të ardhurave nga tatimet dhe taksat duke zbatuar drejtë dhe me efikasitet procedurat tatimore dhe duke synuar në reduktimin e evazionit fiskal. Ky objektivi shkon paralel me nxitjen e vetëvlerësimit dhe vetëdeklarimit të detyrimeve të taksapaguesit, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve ligjore dhe nënligjore, detyrimin e administratës së taksave për të informuar taksapaguesit, agjentët tatimorë me të gjitha mjetet dhe mënyrat që disponon. Krijimi i sistemeve dhe rrjeteve të informacionit dhe ofrimi i shërbimeve ndaj taksapaguesve nëpërmjet teknologjisë së informacionit, si dhe të shërbimit në sportel me një ndalesë.

Struktura aktuale e DPTTV, në katër drejtoritë operacionale kryen komplet ciklin e vlerësimit të detyrimit dhe marrëdhënieve me taksapaguesit si dhe ciklin e inspektimit brenda një linje vertikale për një territor të caktuar, pra planifikimi dhe implementimi gjenden brenda të njëjtave struktura për ndarje territoriale, duke mos dhënë një panoramë të qartë për ecurinë e procesit në të gjithë territorin e administruar, aktualisht Drejtoritë operacionale (4) kanë një ndarje territoriale që përfshin një pjesë të territorit urban (brenda vijës së verdhë) dhe një pjesë të territorit rural.

Kësisoj propozojmë që strukturës aktuale prej 200 punonjësish ti shtohet **20 punonjës** dhe kryesisht ndryshimet do të prekin:

Riformatimin e Drejtorisë Operacionale dhe Teknike, shtimin e Sektorit të Tregjeve, i cili do ketë në strukturën e tij 8 specialist + 1 Përgjegjës Sektori dhe do të jetë në varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtori Operacional dhe Teknik.

Krijimin e një Task Force për kontrollin dhe monitorimin e subjekteve taksapagues të cilët ushtrojnë aktivitet në Bashkinë e Tiranës. Kjo task forcë përbën në vetvete një metodë praktike, e

cila do të ndihmojë në arritjen e objektivave të Drejtorisë, në rritjen e nivelit profesional në edukimin e taksapaguesve dhe rritjen e besueshmërisë së tyre nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve të partneritetit me publikun taksapagues dhe sigurimi i ankimit të vullnetshëm të taksapaguesve, garanci të sigurimit të denoncimit vullnetar të rasteve të shmangieve dhe evazionit.

Krijimin e Sektorit të Asistencës dhe Shërbimit ndaj Taksapaguesit, brenda Drejtorisë së BNJ dhe Shërbimeve si një sektor i cili me shtrirjen e re territoriale merr një rëndësi të veçantë pasi konstatohet se nevoja informative, trajtimi i shqetësimeve të taksapaguesve dhe edukimi fiskal i tyre është një nevojë e evidente.

Lëvizje të tjera brenda administratës së DPTTV-së për të përmirësuar efikasitetin dhe realizimin e të gjitha objektivave të përcaktuara për vitin 2017.

Efektet financiare të aplikimit të nivelit të ri të pagave dhe të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2017, për DPTTV, do të jenë 16,432,000 Lekë

DPN1

Drejtorja e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë është institucion buxhetor në varësi të Bashkisë së Tiranës. Kjo Drejtori është krijuar në funksion të një menaxhimi sa më të mirë të punëve publike për mirëmbajtjen e hapësirave dhe objekteve publike të Qytetit të Tiranës. Me numrin aktual prej 441 punonjësish, Drejtorja e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë është Drejtori që zhvillon aktivitetin e saj në territorin e Qytetit të Tiranës.

Qëllimi i kësaj Drejtorie është funksionimi i veprimtarisë së Drejtorive në varësi të saj dhe zbatimi i ligjit. Detyrat kryesore të saj konsistojnë në:

- Administrimin i mirëmbajtjes, zhvillimit, pastrimit të gjelbërimit rrugor dhe të gjelbërimit të zonave të banimit brenda territorit të Bashkisë së Tiranës;
- Administrimin e pastrimit të zonave të pambuluara nga operatret e kontraktuar nga Bashkia Tiranë.
- Krijimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e lulishteve dhe shatërvaneve brenda territorit të Bashkisë së Tiranës;
- Prodhimin dhe furnizimin me lule dhe bimësi për çerdhet, kopshtet dhe shkollat nën administrimin e Bashkisë së Tiranës;
- Administrimin e Landfill-it të Tiranës dhe evadimin e mbetjeve sipas nevojave dhe urdhërësive të Bashkisë së Tiranës;

Gjatë vitit 2016, DPN1 ka krijuar 20 lulishtesh të reja dhe rikonstrukcioni i atyre ekzistuese me lule të mbjella me kombinime ngjyrash e formash dhe shkurre dekorative të krasitura në mënyrë të tillë që japin imazhin e figurave të ndryshme, të cilat i kanë dhënë pamje tjetër këtyre

hapësirave si p.sh Lulishtja tek Parlamenti, Lulishte tek Tajvani, Lulishte tek Sahati, Lulishte Pedonale, Lulishte tek Vëllezërit Frashëri, Lulishte 1 Maji, Sheshi Qëndror Kombinat, Lulishte përball Hotel Rogner.

Është punuar fort me elemente si edukimi i qytetarëve nëpërmjet fushatave sensibilizuese të specialistëve të DPN1 për ndarjen e mbetjeve në burim, largimin e personave të paligjshëm nga kontenieret, ndihmuar kjo edhe më shumë nga momenti kur filloi të funksionojë impianti i riciklimit, të gjitha këto në funksion për të mbajtur pastër ambientin duke mos ndotur hapësirën e përbashkët.

Hapja e puseve të ujit pranë lulishteve duke ndihmuar në mirëmbajtjen e këtyre hapësirave të gjelbërta.

Nga Drejtoria e Zhvillimit dhe e Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit janë mirëmbajtur sipërfaqe të gjelbërta (bar); 262337 m², pemë (Drurë) 23745 copë, shkurre 19486 copë, krasitje e drurëve dekorativë 11877 copë drurë, krasitje e shkurreve dekorative 3248 copë, shkurre 13117 m² për t'u kositur, mbledhur dhe transportuar. Ujitje bari me tub gome. sipërfaqe bari gjithsej 582971 m², sipërfaqe e gjelbër (bar) 7735 m², drurë (Pemë) 3136 copë, shkurre 4959 copë, lule 23222 copë, kosha dekorativë me llamarinë 474 copë, stola dekorativë 245 copë.

Për mirëmbajtjen e këtyre sipërfaqeve të gjelbërta dhe bimësisë është e nevojshme më tepër punonjës, pasi volumi i punës nuk arrihet të përballohet duke qënë se kemi mungesë të impjanteve ujitjës për sipërfaqet e gjelbërta, prandaj është e nevojshme që ky shërbim të realizohet nga vetë punëtorët.

Mungesa e numrit të nevojshëm të punonjësve ka sjellë mbingarkesën e punës për punonjësit e DPN1 për të realizuar detyrat e pastrimit dhe të gjelbërimit të qytetit, pasi shpesh herë vetë punëtorët e gjelbërimit janë të detyruar të angazhohen në pastrimin e mbetjeve të realizuar gjatë punës së tyre, apo edhe pastrimin e mbeturinave në rastet kur për punëtorët e pastrimit nuk është e mundur prezenca për të realizuar këto detyra në vend dhe në kohë.

Për këtë arsye propozohet që të ketë një shtesë prej 25 punonjësish në strukturën e DPN1.

Këto shtesa do të jenë kryesisht në:

Për DPN1 kërkojmë të shtohen punonjës tek Sektori i Rrugëve Dytësore, Billoqet e banimit, Sipërfaqe të gjelbërta të Qytetit, pasi me këtë numër shtesë dhe me punonjësit aktualisht të miratuar për këtë sektor do të rritet cilësia e mbulimit me shërbimin e pastrimit të 24 Njësitë Administrative në territorin e Bashkisë Tiranë.

Shtesë në numrin e punonjësve në Njësinë e Monitorimit të Terrenit, duke marr parasysh ndjekjen dhe përditësimin e kontrollit të territorit, evidentimin e problemeve që mund të vijojnë gjatë rrugës, si dhe ndjekjen e vendosjes dhe e mirëmbajtjes së koshave dhe të stolave nëpër lulishte të qytetit.

Sipas Urdhërit Nr.7027 datë 02.03.2016 Për “Menaxhimin e pastrimit të territorit të Tregjeve të Qytetit të Tiranës nga Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtoreve të Qytetit” DPN1 i është shtuar kompetenca për pastrimin e tregjeve, të cilat kërkojnë një fuqi punëtore të caktuar për ta menaxhuar.

Me shtimin e numrit të koshave nëpër qytetin e Tiranës, kemi hasur në problematikën se këto kosha keqpërdoren nga qytetarët prej mungesës së informacionit, duke i ngatërruar ato me kontenierët. Gjithashtu edhe për koshat e riciklimit është vënë re mungesë të informimit qytetar për mënyrën e ndarjes së mbetjeve. Për këtë arsye është kërkuar shtimi edhe i specialistëve në Drejtorinë e Trajtimit të Mbetjeve, Landfillit dhe Riciklimit.

Efektet financiare të aplikimit të nivelit të ri të pagave dhe të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2017, për DPN1 (prej **25 punonjës** dhe **75 punonjës sezonal** për periudhën Janar-Prill), do të jenë 20,125,000 Lekë.

Policia Bashkiake

Bashkia e Tiranës me qëllim përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj nga ana e institucioneve që ka në administrim, propozon rritjen e numrit të punonjësve të Policisë së Bashkisë së Tiranës.

Institucioni i Policisë së Bashkisë së Tiranës, funksionon në bazë të të Ligjit nr 8224 datë 15. 05. 1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe Komunës”, i ndryshuar.

Në vitin 2016 numri total i Policisë Bashkiake është 323 punonjës, nga të cilët 66 ruajnë objektet e Bashkisë dhe 257 të tjerët, kryejnë shërbime të Kontroll Territorit, Sigurisë Rrugore, Ligjshmërisë Fiskale, Sallës Operative dhe Shërbimet Mbështetëse, çka do të thotë se kemi raportin 1 (një) polic për 2474 banorë.

Me qëllim rritjen në një shkallë më të lartë të shërbimeve të Policisë Bashkiake ndaj komunitetit, për të përmbushur me sukses detyrat e saj funksionale, për zgjidhjen e problematikave që ka territori i Bashkisë Tiranë, si zënie e hapësirës publike, tregti e paligjshme, ndotje mjedisi, ndërtime pa leje, prishje të qetësië publike etj, mendojmë se duhet të shtohet numri i punonjësve të Policisë Bashkiake. Shtimi i numrit të punonjësve vjen si domosdoshmëri dhe për shkak të:

- ✓ Rritjes së numrit të popullsisë së qytetit të Tiranës, plus njësitë administrative që pas ndarjes së re territoriale janë pjesë e Bashkisë Tiranë.
- ✓ Shtimit të numrit të automjeteve në qarkullim në mënyrë progresive dhe për pasojë janë shtuar edhe kundravajtjet administrative, nevoja për rritjen dhe forcimin e masave të sigurisë rrugore.
- ✓ Zgjerimit të sipërfaqes së territorit e cila duhet të mbulohet me shërbime të Policisë Bashkiake.
- ✓ Rritjes së numrit të subjekteve juridik dhe fizik, ndaj të cilave duhet të ushtrohet kontroll i vazhdueshëm për zbatimin e ligjshmërisë.

- ✓ Të zënies së hapësirave publike dhe shfrytëzimit të tyre në mënyrë të paligjshme
- ✓ Kërkesës së vazhdueshme për mbështetje e bashkëpunim nga strukturat e ndryshme të Bashkisë Tiranë, si DPTTV, AMK, IMT, DPN Nr. 1, 2, 3, Tirana Parking, UKT dhe Emergjencat Civile në rastet e fatkeqësive natyrore, etj.
- ✓ Kërkesave të përditshme për të mundësuar konstatimin, parandalimin dhe pezullimin e ndërtimeve pa leje dhe dërgim informacioni IMT-së, për procedurë të mëtejshme.
- ✓ Rritjes së numrit të kundravajtjeve për ndotjen e mjedisit, zënien e hapësirës publike, tregtimin e paligjshëm të ujit të pijshëm, prishje të qetësisë publike etj.
- ✓ Rritjes së numrit të gjobave të vendosura në raport me vitin 2012, vjelja e tyre dhe për pasojë rritja e të ardhurave.
- ✓ Numrit të madh të aktiviteteve që organizohen nga/ose me lejen e Bashkisë e Tiranë, ku në vazhdimësi kërkohet mbështetja e Policisë Bashkiake.
- ✓ Rritjes së numrit të ankesave të ardhura nga qytetarë apo institucione me shkresë, në sallën operative nëpërmjet telefonit fiks si dhe nëpërmjet portalit online Tirana Ime.
- ✓ Shtimit të numrit të objekteve pronë e Bashkisë, që ruhen me punonjës të Policisë Bashkiake.
- ✓ Të nevojës për mbështetje dhe bashkëpunim me firmat e ndryshme që kryejnë punë publike në territorin e Bashkisë Tiranë.
- ✓ Rritjes së distancës nga qendra e Bashkisë Tiranë deri në pikat ekstreme territorit të njësive administrative.

Gjithashtu ju informojmë se, numri i subjekteve të regjistruara me aktivitet biznesi në Tiranë në vitin 2015 ka qënë 36608, ndërsa në vitin 2016 janë 44369 subjekte të regjistruara në QKR dhe QKL. Në vitin 2016, kemi një rritje me 7761 ose 21.2% subjekte të regjistruara më shumë se në vitin 2015, të cilat duhen kontrolluar për zbatimin e ligjshmërisë, mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe bllokimin e tyre deri në likuidimin e plotë të detyrimeve, për hapësirat publike, për respektimin e orarit të shërbimit, për zbatimin nga ana e tyre të rregulloreve apo urdhërave të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë etj.

Për sa më sipër, propozojmë shtimin me **50 punonjës të Policisë Bashkiake**. Efektet financiare të aplikimit të nivelit të ri të pagave dhe të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2017, do të jenë 38,510,000 Lekë.

DPN2

Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit është krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr.13, datë 10.03.2004 dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr.7, datë 30.03.2009, duke funksionuar si institucion buxhetor në varësi të Bashkisë së Tiranës.

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, (qyteti i Tiranës aktualisht i përbëhet nga 14 njësi administrative), DPN2PQ iu shtua volumni i punës. U shtua sipërfaqja e rrugëve kryesore dhe jo kryesore, e trotuarëve dhe shesheve publike, e zgarave dhe kunetave të ujrave të bardha, e ndriçimit publik dhe rrjetit të semaforëve, e sinjalistikës rrugore, mirëmbajtja e të cilave, përbën fokusin dhe objektivin kryesor të punës së ndërmarjes.

Në këto kushte u evidentua domosdoshmëria e riorganizimit të punës, proces i cili u finalizua me daljen e Urdhërit Nr.3185 datë 01.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë, "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.56 date 24.12.2012, për "Riorganizimin e strukturës organizative të disa Institucioneve në Varësi të Bashkisë së Tiranës". Si rrjedhojë, struktura organizative e DPN2PQ, u rrit në 350 punonjës dhe u riformatua organigrama e saj.

Në vijimësi të punës, në mbështetje të VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të Personelit dhe të Aseteve të Luajtëshme e të Paluajtëshme të Bordeve Rajonale të Kullimit" si dhe të neneve 3, shkronja "dh", e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Bordi i Kullimit i Tiranës, do të jetë nën menaxhimin e Bashkisë Tiranë, (bordet e kullimit janë krijuar në zbatim të Ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin" i ndryshuar me Ligjin nr.9860, datë 21.1.2008).

Në kuadër të mirëfunksionimit të punës, DPN2 i është ngarkuar detyra, për mirëmbajtjen e sistemeve të kullimit, pastrimit e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese e mbledhëse, stacioneve të pompave të kullimit, hidrovoreve, digave, detyra të mëparshme të Bordit të Kullimit, Tiranë si dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale, si rrjedhojë e së cilës struktura organizative e DPN2 u bë me 389 punonjës gjithsej.

Gjatë kësaj periudhë DPN2 është ballafaquar me kërkesat në rritje të Njësive Administrative, për mirëmbajtjen e rrugëve kryesore dhe jokryesore, të zgarave dhe kunetave të ujërave të bardha, e ndricimit publik, e sinjalistikës rrugore, kanaleve kulluese dhe ujitëse, rezervuarëve etj., mirëmbajtja e të cilave përbën fokusin dhe objektivin kryesor të punës së Drejtorisë.

Për të përmbushur objektivat e mësipërme për përmirësimin e mirëqënies dhe rritjes së cilësisë së jetesës së komunitetit, dhe për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave për ndërhyrje emergjente nga ana e Njësive administrative dhe menaxhimit të sezoneve problematike të seksionit të administrimit të ujërave, është propozuar shtimi i strukturës organizative me **35 punonjës** me kontratë më afat të pacaktuar dhe **50 punonjës sezonal** për periudhën Prill – Qershor.

Efektet financiare të aplikimit të nivelit të ri të pagave dhe të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2017, do të jenë 25,867,000 Lekë

AMK

Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 10, datë 12.10.2011 për "Krijimin e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës" i ndryshuar me gërmën "d" të pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Bashkisë së Tiranës nr. 56, datë 24.12.2012 "Për riorganizimin e strukturave organizative të disa institucioneve në varësi

të Bashkisë së Tiranës”, vendimet e Këshillit të Bashkisë së Tiranës që kanë të bëjnë me “Vendosjen e gjobave nga Bashkia e Tiranës”, “Vendosjen e gjobave për shkeljet e kryera nga shoqëritë e ndërtimit”, “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimit të qytetit” dhe “Për vendosjen e gjobave në vend ndaj subjekteve për shkeljet e kryera në fushën e transportit rrugor”.

Në themel të punës së saj ka mbrojtjen e disa të drejtave të konsumatorit dhe është konsideruar si simbol i sinkronisë dhe bashkëpunimit mes pushtetit vendor dhe atij qendror. AMK synon të rrisë bashkeveprimin, efektivitetin e punës për përmbushjen e objektivave të planifikuara nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe kontrollit të vazhdueshëm.

Nisur nga raporti I Auditimit të performancës së “Sherbimit të transportit publik në Bashkinë e Tiranës”, në zbatim të rekomandimeve të përcjella nga KLSH, dhe nga kërkesat në rritje për mbarëvajtjen e punës së këtij institucioni, në rritje të vazhdueshme të performancës së tij, është parashikuar një ndarje e sektorit të Kontrollit të Ndotjes dhe Monitorimit të Sherbimeve të Transportit Publik në dy sektorë dhe një dhe një shtim të numrit të inspektorëve, në mënyrë që të bëhet sa më eficient kontrolli dhe monitorimi I transportit publik, gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij ditore.

Gjithashtu në Klinikën Veterinare, shikohet e domosdoshme shtimi I personelit mbështetës, pasi mjekët veterinerë punojnë më 3 turne, e përveç kontrollit të kafshëve endecake I duhet të merren edhe me trasnportin të kafshëve nga vendet ku janë vendosur pas kapjes, deri në sistemimin e tyre pas trajtimit apo ndërhyrjes kirurgjikale.

Në administratën e AMK-se, sipas kërkesave të inspektimit e nje mbarëvajtje më të mirë të punëve të brendshme, propozohen edhe disa levizje.

Numri në total i punonjësve të shtuar do të jete **15 punonjës**. Efektet financiare të aplikimit të nivelit të ri të pagave dhe të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2017, do të jenë 14,680,000 Lekë .

Qendra Kulturore Tirana

QKT është institucion në varësi të Bashkisë Tiranë i cili ka për detyrë administrimin e aseteve fizike dhe burimeve njerëzore të entiteteve publike artistike të qytetit. QKT është përgjegjëse për krijimin dhe realizimin cilesor të aktiviteteve artistike nëpërmjet këtyre aseteve dhe përmbledh në strukturën e saj:

1. Teatri Metropol
2. Ansambli Tirana
3. Banda e Qytetit
4. Kinema Agimi

Aktualisht QKT ka një staf prej 37 punonjësish.

Për vitin 2017 është duke u punuar me rikonstrukcionin e Kinema Laprakës dhe propozohet që të shtohet Sektori I që do të menaxhojë dhe vërë në efencë këtë Kinema pas rikonstrukcionit.

Gjithashtu drejtorja ka parë të domosdoshme shtimin edhe të disa pozicioneve që nuk kanë ekzistuar në parë në strukturën e saj. Sektori Administrativ, koordinon dhe realizon të gjitha detyrimet administrative që kërkon kuadri ligjor, realizon tenderat dhe blerjet e vogla, koordinimin e burimeve njerëzore, harton dhe koordinon të gjitha kontratat juridike që institucioni lidh me të tretet, kujdeset për arkivimin dhe protokollimin e gjithë dokumentacionit përkatës. Ky sektor ka nevojë për ndarjen e detyrave të Juristit dhe Specialistit të Burimeve Njerëzore, që aktualisht kryhen nga i njëjti person. Propozohet shtimi i një pozicioni Jurist.

Gama e gjere e aktiviteteve teatrore, koncerteve, aktiviteteve kulturore, etj. kërkon prodhim të vazhdueshëm të imazheve për promovim dhe marketim, spoteve dhe trajlerave, posterave, etj, si dhe arkivimin audio-vizual të këtyre aktiviteteve me rëndësi kulturore dhe historike. Një nga problemet kryesore të QKT në fillim të vitit 2016 ishte mungesa e vizibilitetit si pasojë e keqmenaxhimit të kësaj institucioni që administron asetet kulturore të qytetit. Brenda një viti, një fashë e gjerë e popullsisë së qytetit, sidomos moshë 14-35 vjeç që nuk merrte pjesë në aktivitete teatrore dhe muzikore të QKT është përfshirë në mënyrë eksponenciale në këto aktivitete. QKT ka synim strategjik rritjen e vizibilitetit të institucionit dhe aktiviteteve të tij duke shtuar në strukturë dhe specialistin për Foto/Video, ndaj është propozuar shtimi i specialistit për Fotograf/Videograf.

Në total numri i stafit të shtuar të QKT do të jetë **8 punonjës**. Efektet financiare të aplikimit të nivelit të ri të pagave dhe të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2017, do të jenë 6,464,000 lekë.

Qendra Rinore Ten

Është një qendër e krijuar me vendim me VKB nr.47 datë 06.07.2016 si një strukturë në mbështetje të jetës dhe pjesëmarrjes sociale dhe angazhimit të të rinjve të kryeqytetit në një jetë aktive dhe të angazhuar për promovimin, zhvillimin dhe kualifikimin e të gjithë talenteve të reja, në të njëjtën kohë duke nxitur edhe krijimtarinë artistike dhe atë të artit bashkëkohor, nëpërmjet mbështetjes së artistëve të rinj. Riorganizimi i kësaj qendre I ka dhënë një mundësi të mirë për kuptimin dhe informimin me rrjedhat e krijimtarisë kulturore. Struktura e kësaj qendre është propozuar të zgjerohet me 3 punonjës , për shkak se gjatë vitit 2017 është parashikuar zgjerimi i këtyre lloj kontributesh në komunitet në disa njësi të tjera administrative.

Efektet financiare të aplikimit të nivelit të ri të pagave dhe të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2017, do të jenë 2,600,000 Lekë.

Shpenzimet Operative

Shpenzimet operative janë parashikuar në shumën 4,791,392,000 lekë për vitin 2017, 4,975,000,000 lekë për vitin 2018 dhe 4,996,000,000 lekë për vitin 2019. Këto shpenzime përbëjnë 33% të totalit të buxhetit për vitin 2017.

Në thelb të planifikimit të shpenzimeve operative është racionalizimi i shpenzimeve administrative, duke vënë theksin në rritjen e financimit për shërbimet publike me qëllimin e përdorimit të tyre për përmbushjen e funksioneve kryesore të Bashkisë së Tiranës.

Shpenzimet operative shënojnë një rritje prej 6% në krahasim me vitin 2016 dhe parashikohet të rriten me 3% dhe 4% respektivisht për vitet 2018 dhe 2019.

Megjithëse në vazhdimësi synohet rritja e peshës së financimit të shpenzimeve kapitale, ekperiencia e vitit të fundit ka treguar se nëpërmjet shërbimeve direkte dhe fleksible sa më afër qytetarëve dhe nevojave të tyre, janë arritur rezultate të shkëlqyera nëpërmjet punës së ndërmarrjeve të Bashkisë

Peshën më të madhe në shpenzimet operative e mbajnë funksionet prioritare të Bashkisë së Tiranës: shërbimet publike vendore, arsimit parauniversitar dhe mirëmbajtja e rrugëve.

Shpenzimet operative të programeve të shërbimeve publike si pastrimi, gjelbërimi, mirëmbajtja e rrugëve dhe mirëmbajtja e infrastrukturës arsimore e çerdheve përbëjnë 74% të totalit të këtyre shpenzimeve.

Rreth 17 % e këtyre shpenzimeve shkojnë në programet e kujdesit social, kulturës, rinisë, sportit, zhvillimit ekonomik e punësimit si dhe mbrojtjes civile.

Vetëm 9%, (3.5% e buxhetit total) e shpenzimeve operative shkojnë për administratën e Bashkisë së Tiranës.

2. Fondi rezervë dhe kontigjenca

Për periudhën afatmesme 2017-2019, Fondi rezervë dhe ai i Kontigjencës, është llogaritur sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Këto fonde do të përdoren sipas përcaktimeve ligjore:

Fondi Rezervë do të përdoret për financimin e shpenzimeve që nuk mund të parashikohen gjatë hartimit të buxhetit, me vendime të Këshillit Bashkiak;

Fondi i Kontigjencës do të përdoret për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve egzistuese, në rast se do të jetë e nevojshme gjithmonë me miratimin e Këshillit Bashkiak.

3. Transferta për Individët

Transfertat për individët përbëhen nga transfertat për mbështetje sociale të shtresave në nevojë si bonusi i qerasë, stimuj ekselence, si ai për nxënësit e shkëlqyer dhe stimuj të tjerë si pagesa për bebet, të cilat do të vazhdojnë të paguhen edhe gjatë vitit 2017.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Njësitë e qeverisjes vendore, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky fond përfitohet për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë njësitë e qeverisjes vendore, në fushat e infrastrukturës rrugore vendore, arsimit, etj.

Projektet miratohen nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, mbi bazën e politikave dhe programeve të zhvillimit të rajoneve të Shqipërisë i cili përcakton edhe masën e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore. Komiteti merr vendime bazuar në raportet e sekretariateve teknike të Ministrive të Linjës, të cilat bëjnë vlerësimin tekniko-ekonomik dhe listimin e projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në VKM nr.135, datë 03.02.2010 për "Përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve".

Në kuadrin e aplikimeve të reja për përfitimin e projekteve nga FZHR për vitin 2016, Bashkisë së Tiranës i janë miratuar projekte të reja si më poshtë të cilat janë në vazhdim:

Programi i Menaxhimit të Rrugëve

- 1- Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej,
- 2- Rikualifikimi i urban i bllokut nr.1 (Lapraka)
- 3- Rikualifikim urban i rrugëve në bllokun e pallateve "Selitë", të kufizuar nga Rr. "Hamdi Pepa",Rr."Ilia Dilo Sheperi", Rr."Visarion Xhuvani" dhe Rr."Leka i Madh" Nja 5
- 4- Rehabilitim i varrezave Sharrë dhe lidhja me rrugën ekzistuese Kombinat
- 5- Itenerare këmbësorësh me pistë vrapimi dhe bicikletash në Parkun e Liqenit Artificial
- 6- Rikualifikim i Pazarit të Ri (Markata e Mish-Peshkut, restaurim i 4 objekteve dhe rikonstruksion i fasadave përreth sheshit Avni Rustemi dhe pajisjet)
- 7- Sistem i qendërzuar për menaxhimin e hoteleve dhe taksave të qëndrimit në Bashkinë e Tiranës
- 8- Forcimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ne Bashkine e Tiranës
- 9- Linearizimi financiar ne institucionet e varesise te Bashkise Tirane
- 10- Sistemi elektronik i inventarizimit, regjistrimit dhe perdorimit te aseteve te Bashkise Tirane
- 11- Linearizimi i menaxhimit te aseteve ne institucionet e varesise te Bashkise Tirane
- 12- Kanalizime te ujrave te zeza Petrele

Programi i Arsimit

- 1- Rikonstrukcion i Shkollës koreografike Tiranë
- 2- Ndertim i salles se koncerteve, prane auditorit te Liceut Artistik "Jordan Misja"
- 3- Rikonstrukcion, shtese anesore 2 kate dhe palester per shkollen e mesme te komunes Vaqarr
- 4- Ndertim i shkolles 9 vjeçare "Kosova" Tirane
- 5- Ndertim i shkolles 9 vjeçare fshati Mihajas

Në **Programin e Ujitjes dhe Kullimit**, funksion i transferuar në Bashkinë e Tiranës, është miratuar vendimi për akordimin e fondeve për:

1. Blerje eskavatore me zinxhire
2. Rehabilitim i kanalit ujites Vilez, Zall Bastar
3. Rehabilitimi i rrjetit te kanaleve ujites TRU-20, Kanali Arbane

KAPITULLI V PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË QYTETIT

Ky kapitull, prezanton me hollësi politikat, qëllimet, objektivat dhe produktet e secilit prej programeve të zhvillimit të qytetit që parashikohen të realizohen për periudhën në vazhdim nga të gjitha njësitë shpenzuese të Bashkisë së Tiranës.

Bazuar në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), në strukturat buxhetore të programeve që parashikojnë aktet ligjore mbi buxhetin si edhe në funksionet që ushtron aktualisht Bashkia e Tiranës, programet e zhvillimit të qytetit janë:

- SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE
- MENAXHIMI I RRUGEVE DHE TRANSPORTIT PUBLIK
- ARSIMI PARA-UNIVERSITAR DHE EDUKIMI
- KUJDESI SOCIAL
- STREHIMI DHE PLANIFIKIMI I TERRITORIT
- ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PUNËSIMI
- KULTURA DHE TURIZMI
- ZHVILLIMI I RINISË DHE SPORTIT
- PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI
- RENDI DHE MBROJTJA CIVILE

Totali i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës (korente dhe kapitale) në mijë lekë, për çdo program mbështetur në të ardhurat e veta paraqitet në tabelë e mëposhtme:

Buxheti total 2017-2019

Programi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1 Shërbimet Publike Vendore	4,455,712	3,965,909	4,006,662
2 Menaxhimi i Rrugëve dhe Transportit Publik	3,258,514	3,136,581	3,243,913
3 Arsimit Parauniversitar dhe Edukimi	2,353,674	2,188,172	2,189,925
4 Kujdesi Social	317,508	272,484	409,148
5 Strehimi dhe Planifikimi i Territorit	593,529	910,061	1,045,633
6 Zhvillimi Ekonomik dhe Punësimi	85,000	90,000	65,000
7 Kultura dhe Turizmi	241,534	223,732	261,919
8 Rinia dhe Sportit	119,207	124,271	155,271
9 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,590,054	2,604,087	2,406,914
10 Rendi dhe mbrojtja civile	396,145	325,085	326,085
11 Ujesjelles kanalizime	10,000	10,000	10,000
12 Mbrojtja nga zjarri	6,043	6,000	6,000
TOTALI	14,426,920	13,856,382	14,126,470